



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Lënda:** *Raport i Veçantë lidhur me respektimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, si dhe e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut e të palëve në procesin penal<sup>1</sup>.*

**PROKURORISË SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË KUNDËR  
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

**GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË KUNDËR  
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

**GJYKATËS SË POSAÇME TË APELIT KUNDËR KORRUPSIONIT  
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË**

**KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

---

<sup>1</sup> Raport përgjithësues nisur nga rasti i gazetarit Elton Qyno

# KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

### MINISTRISË SË DREJTËSISË

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Në institucionin e Avokatit të Popullit në muajin dhjetor 2023 ka paraqitur një ankesë shtetasi Elton Qyno, me profesion gazetar, pranë medias audiovizive Ora News sh.p.k. Shqipëri<sup>2</sup>.

Ankuesi parashtron se në datën 13.12.2023, rreth orës 10:00, është thirrur nëpërmjet telefonit nga një oficer i Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) për t'u paraqitur në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) për t'u njohur me një urdhër ndalimi për mospublikimin e informacioneve. Pasi ai është paraqitur në këtë institucion, i është komunikuar se do të pyetet në cilësinë e personit që ka dijeni për disa akte hetimore që i përkasin çështjes penale nr. 75, të vitit 2022, të cilat përbëjnë sekret hetimor.

Ai parashtron se në vijim, është mbajtur për disa orë (nga ora 11:00 deri në orën 18:00) në një nga zyrat e këtij institucioni, duke e izoluar (mbyllur derën me çelës) dhe është pyetur lidhur me burimin e informacionit të publikuar, si dhe i është kërkuar dorëzimi i aparateve telefonikë që kishte në përdorim. Për arsye se sipas rregullave të këtij institucioni nuk lejohen që aparatet e telefonit të futen në ambientet e tij, ato i kishte lënë në një bar-kafe, me emër “Bar-Kafe Class”, i cili ndodhet përballë godinës së SPAK.

---

<sup>2</sup> Më herët rasti ishte bërë publik edhe në media dhe kishte tërhequr vëmendjen tonë institucionale.

Meqenëse ai nuk e ka deklaruar burimin e informacionit dhe nuk i ka dorëzuar aparatet e telefonit, me kërkesë të SPAK, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka marrë ndaj tij tre vendime respektivisht me nr. 500, datë 13.12.2023, “Për lejimin e kontrollit të banesës”; nr. 501, datë 13.12.2023 “Për paraqitjen e të dhënave kompjuterike” dhe nr. 502, datë 13.12.2023 “Për lejimin e kontrollit personal”.

Gjithashtu ankuesi shkruan se deri në datën 13.12.2023, nuk është paralajmëruar nga prokurori për mospublikim të akteve të dosjes penale nr. 75, të vitit 2022 dhe se ai nuk akuzohet vetë për kryerjen e veprës penale, por hetimi është fokusuar te prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore që kanë detyrimin për të ruajtur sekretin hetimor.

Në zbatim të vendimeve gjyqësore të cituara më sipër, atij i janë bërë kontrollet dhe sekuestrimi i dy aparateve të telefonit celular, kompjuterit personal, kompjuterit të punës, CD, DVD, dhe i disa sendeve të tjera personale.

Ankuesi pretendon se nga ana e SPAK janë tejkaluar kompetencat ligjore, sepse i është bërë kontroll i automjetit të tij, si dhe i janë sekuestruar dy aparatet e telefonit dhe disa sende personale të tij dhe të fëmijëve të mitur, për të cilat nuk ka patur vendim kontrolli dhe vendim sekuestrimi nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Sipas ankuesit, si pasojë e këtyre veprimeve i janë shkelur të drejtat e garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, respektivisht neni 22, paragrafi 1 e 2, për lirinë e shprehjes dhe atë të shtypit (ushtrimin e profesionit të gazetarit), neni 36 për fshehtësinë e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit, neni 37 për paprekshmërinë e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të dhe neni 31/ç për të patur ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, si dhe ligji “Për shtypin” nr. 7756, datë 11.10.1993, i ndryshuar.

Përveç sa më sipër, ankuesi shkruan se për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese e ligjore, në datën 18.12.2023, ka bërë ankesë në Gjykatën e

Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, respektivisht në nenin 19, gërma *“b”* ku parashikohet se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, në nenin 20 ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror”*, si dhe në paragrafin e fundit të nenit 19 ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”*, me shkresat nr. K2/E18-2 prot., datë 27.12.2023 dhe nr. K2/E18-3 prot., datë 31.01.2024, drejtuar SPAK, i kërkuam dërgimin e një informacioni lidhur me këtë ankesë dhe konkretisht:

1. Cilat janë arsyet dhe baza ligjore e thirrjes në institucionin tuaj të gazetarit Elton Qyno?
2. Cili është qëndrimi juaj lidhur me pretendimet e gazetarit Elton Qyno se është izoluar në një nga zyrat e këtij institucioni, duke e mbajtur të mbyllur me çelës nga ora 11:00 deri në orën 18:00, të datës 13.12.2023?
3. Cili është qëndrimi juaj ndaj pretendimeve të ankuesit se atij i është bërë kontrolli i automjetit dhe i janë sekuestruar disa sende personale të tij dhe të fëmijëve të mitur, të cilat nuk janë parashikuar në vendimet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të cituara më sipër?
4. Nëse nga oficerët e policisë gjyqësore të SPAK janë kryer veprimet e kontrollit të automjetit dhe sekuestrimi i sendeve personale për të cilat

pretendon ankuesi, a janë zbatuar nga organi juaj detyrimet e parashikuara në nenet 298/4 dhe 301 të Kodit të Procedurës Penale për të bërë me vendim të motivuar vleftësimin e kontrollit dhe të sekuestros. Dhe nëse është zbatuar kjo procedurë, a është bërë njoftimi i ankuesit e dhënë atij kopje e vendimit përkatës brenda afatit ligjor?

SPAK me shkresën nr. 2266/1 Prot/B.D., datë 08.02.2024, ndërmjet të tjerave na informoi se, ky organ po kryen hetime në procedimin penal nr. 75/2022 për një sërë veprash të rënda penale të kryera kundër jetës e pronës nga një grup i gjerë personash (rreth 34 persona, 21 prej të cilëve të arrestuar tashmë) me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe të akuzuar për 27 ngjarje të rënda kriminale të cilët kanë vepruar si një grup i strukturuar kriminal, aktiviteti kriminal i të cilëve është zbuluar e dokumentuar kryesisht nga një prej të pandehurve që ka fituar statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, jeta e të cilit dhe e familjarëve të tij mbrohet me ligj të veçantë.

Në kuadër të kësaj ndërmarrjeje hetimore dhe në konsiderim të faktit të konstatuar në faqet e internetit të mediave audiovizive, të publikimit të disa artikujve në përmbajtje të të cilëve viheshin re dukshëm biseda të koduara në platformën SKY/ECC, të bashkëpunëtorit të drejtësisë në rastin në hetim, me bashkëkomunikues/përdorues të platformës SKY/ECC (*të pa identifikuar saktësisht nga hetimet*), me artikullshkrues Elton Qyno<sup>3</sup>, u ngritën dyshime mbi faktin se, persona nga grupi i hetimit në Prokurorinë e Posaçme, që kanë detyrimin ligjor të ruajtjes së sekretit mbi informacionin e klasifikuar të komunikimeve në platformën SKY/ECC, e kishin zbuluar atë për të tretët, ndaj u fillua menjëherë një hetim për veprën penale “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, parashikuar nga neni 295/a, paragrafi 3 i Kodit Penal.

Meqenëse kjo u konsiderua urgjente, u ftua gazetari Elton Qyno për t’u marrë në pyetje si person që ka dijeni për këtë fakt. Gjatë marrjes në pyetje ai u ftua që të vinte në dispozicion të organit hetues gjithë informacionin që kishte mbi komunikimet në platformën SKY/ECC mbi këtë rast hetimor, qoftë në formatin dokument dhe/ose në formë elektronike. Por ai u përgjigj negativisht, megjithëse iu bë e ditur se zbulimi i të dhënave sekrete hetimore, përmes publikimit ishte i palejueshëm me ligj dhe se në vetvete publikimi i

---

<sup>3</sup> Artikull dt. 14.12.2023 “Nëse dalin përgjimet e SKY, në Shqipëri shpërthen një vullkan”, artikuj online Ora News Tv dt. 10.12.2023 dhe dt. 11.12.2023.

këtyre komunikimeve nuk përbënte interes publik, veç shtimit të kureshtjes për t'u njohur me to dhe se në këtë rast prevalonte interesi hetimor për t'i kërkuar e gjetur ato informacione në çfarëdo lloj forme që ai t'i dispononte ato.

Në këto rrethana, me synimin për të gjetur dokumente, prova materiale, gjurmë ose sende që i përkisnin veprës penale “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete” dhe për të shmangur mundësinë/rrezikun e humbjes, u miratuan në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO) vendimi nr. 500, datë 13.12.2023 “Për lejimin e kontrollit tek vendi i punës, zyrat e TV Ora News dhe në banesën e tij”; vendimi nr. 501, datë 13.12.2023 “Për lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik në vendin e punës dhe në banesën e tij” dhe vendimi nr. 502, datë 13.12.2023 “Për lejimin e kontrollit personal”. Sekuestrimi u çmua i nevojshëm nga gjykata dhe për aq kohë sa do të nevojitej kjo procedurë. *Veçanërisht sekuestrimi i të dhënave kompjuterike ishte i nevojshëm për të gjetur prova që vërtetonin ekzistencën e faktit objekt hetimi dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete nga zyra hetuese që në kuadër të hetimit të mëparshëm, ishte e vetmja që i dispononte këto informacione të klasifikuara deri në fazën fundore të hetimit paraprak.*

Nga kontrolli në banesë dhe në ambientet e punës u gjetën dhe u sekuestruan dokumente dhe sende elektronike tek të cilat dyshohet të ketë gjurmë të veprës penale që po hetohet. Ato po i nënshtrohen ekzaminimit laboratorik.

Me këtë veprim procedural penal, të sekuestrimit të dokumenteve, sendeve e provave materiale që lidhen me hetimin e çështjes, atij nuk i janë vënë në rrezik sekrete profesionale të gazetarit, siç pretendon, pasi sekuestrimet janë bërë në konsiderim të proporcionalitetit të nevojës hetuese, siç nuk i është kërkuar që me patjetër të tregojë burimet e tij të informacionit gazetaresk.

Gjithashtu u informuam se, nga konsultimi i akteve të hetimit të procedimit penal nr. 75/2022 është konstatuar se që në datën 14.06.2022, gazetarit në fjalë i është komunikuar urdhërimi për mospublikimin e akteve procedurale të procedimit penal nr. 75/2022.

Po ashtu në këtë shkresë, u informuam se gazetari Elton Qyno është thirrur në këtë organ për t'u marrë në pyetje e dëgjuar si person që ka dijeni për rrethanat e faktit penal objekt hetimi. Ai nuk është mbyllur në ndonjë zyrë me çelës apo izoluar dhe t'i jenë sekuestruar sendet e fëmijëve sikurse pretendon.

Përveç sa më sipër, nga SPAK u informuam se sendet e sekuestruara gjatë kontrollit dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik në vendin e punës dhe në banesën e tij janë vleftësuar konform procedurës dhe ai është njohur me këto akte dhe i ka kundërshtuar ato në gjykatë.

Në vijim të ndjekjes së kësaj ankese, përveç dy kërkesave të cituara më sipër drejtuar SPAK, një përfaqësues i institucionit tonë mori pjesë në cilësinë e vëzhguesit në seancat gjyqësore të zhvilluara në datat 26 dhe 27 dhjetor 2023 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar e cila gjykoi ankesën e shtetasit Elton Qyno.

Ndërsa në datën 05.01.2024, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar mori në shqyrtim ankesën e shtetasit Elton Qyno. Institucioni ynë dërgoi në këtë organ një përfaqësues të pajisur me autorizim për të qenë i pranishëm në seancën gjyqësore me cilësinë e vëzhguesit, por ai nuk u pranua nga gjykata që të merrte pjesë në proces<sup>4</sup>.

### **Rrethanat e çështjes.**

Nga dokumentacioni dhe informacioni i administruar nga institucioni ynë rezulton se, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (GJKKO) ka vendosur të kryejë kontrollin personal, kontrollin e banesës dhe sekuestrimin e të dhënave elektronike të ankuesit të papërcaktuara, që përfshijnë të dhënat që ndodhen në aparate telefonikë celular, kompjuterat personalë dhe të punës, USB, CD, DVD, etj.

---

<sup>4</sup> Kjo çështje do të trajtohet në mënyrë të hollësishme në vijim të këtij raporti.

SPAK po heton procedimin penal nr. 75/2022 për disa vepra penale të rënda të kryera nga një grup i strukturuar kriminal. Ky hetim është regjistruar me Nr. 75/2 viti 2022, janë kryer të gjitha veprimet hetimore duke u njoftuar akuza edhe për të pandehurit dhe është dërguar për gjykim pranë GJKKO.

Më 12.12.2023, mbi bazë të një materiali referues të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), SPAK ka regjistruar procedimin penal nr. 245/2023 për veprat penale "Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete" dhe "Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin", parashikuar përkatësisht nga nenet 295/a, paragrafi 3 dhe 313/b, pika 1, të Kodit Penal<sup>5</sup>. Ndërkohë nga SPAK është vendosur që procedimi penal nr. 245/2023 të bashkohet me procedimin penal nr.75/2022 për t'u hetuar në një të vetëm me nr.75/2022.

Sipas SPAK, më datë 10.12.2023, në faqen e internetit të medias Ora News TV është publikuar artikulli me titull: *"O miq o armiq, ose më trego ato fis q\*\*at..."*. Dumani: *Nga vjedhja e 26 armëve humba 100 mijë euro, ti fitove 200 €", dhe nga referenca dilte që ky artikull është publikuar nga ankuesi, gazetari Elton Qyno. Një ditë më pas, më datë 11.12.2023, në portalet online të mediave audiovizive oranews.tv dhe dritare.net, janë publikuar artikujt me titull "Do vrisnin Suel Çelën se rrahu Ben Lazen, por u dekonspiruan. Dumani: Po gjeta spiunin do ta rrjep, do t'i ha fëmijët". Nga referenca në portalin oranews.tv, rezulton se edhe artikullin e fundit e ka publikuar gazetari Elton Qyno. Sipas organit procedues, konstatohet se teksti në këto publikime përmban pjesë të komunikimeve që bashkëpunëtori i drejtësisë, i pandehuri Nuredin Dumani ka bërë me disa persona në platformën e kriptuar SkyECC.*

Po ashtu, sipas këtij organi, këto shkrime përmbajnë të dhëna nga akte hetimore që janë sekrete dhe ndodhen para faktit të zbulimit të akteve hetimore sekrete apo i të dhënave që përmbajnë aktet sekrete në procesin e bashkëpunimit të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, si dhe para faktit të publikimit në kundërshtim me ligjin i të dhënave me karakter të klasifikuar.

---

<sup>5</sup> Njoftim per shtyp SPAK dt. 14.12.2023.



Më 13.12.2023, rreth orës 10:00, ankuesi është njoftuar nëpërmjet telefonit nga një oficer i policisë gjyqësore efektiv i BKH për t'u paraqitur në SPAK me qëllim për t'i komunikuar një urdhër të ri për mospublikimin e akteve hetimore në funksion të nenit 295/a, paragrafi 4 i Kodit Penal.

Pasi është paraqitur në këtë organ rreth orës 11:00, ai është izoluar kundër dëshirës së tij brenda ambienteve të këtij organi, duke i mbyllur derën me çelës deri në orën 18:00. Aty është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për faktet dhe konkretisht se si është vënë në dijeni të akteve hetimore të publikuara të cilat përbëjnë sekretet hetimor. Sipas SPAK, ai ka rënë në dijeni për shkak të profesionit si gazetar profesionist dhe ka lindur domosdoshmëria për të treguar burimin e informacionit të akteve sekrete. Ndaj i kanë kërkuar z. Qyno se si i ka siguruar këto informacione dhe nga kush. Kësaj kërkesë, ankuesi i është përgjigjur se burimi i informacionit është konfidencial dhe për këtë arsye nuk mund ta deklarojë atë për shkak të profesionit të gazetarit. Sqarojmë se sipas përgjigjes së dërguar nga SPAK, **gazetari Elton Qyno nuk është mbyllur në ndonjë zyrë me çelës apo të jetë izoluar.**

SPAK po heton procedimin penal nr. 75/2022 për disa vepra penale të rënda të kryera nga një grup i strukturuar kriminal dhe në dt. 12.12.2023, mbi bazë të një materiali referues të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), ka regjistruar procedimin penal nr. 245/2023 për veprat penale "Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete" dhe "Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin", parashikuar përkatësisht nga nenet 295/a, paragrafi 3 dhe 313/b, pika 1, të Kodit Penal<sup>6</sup>. Ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr.75/2022 për t'u hetuar në një të vetëm me nr.75/2022, në një kohë që në shkresën sjellë nga SPAK, nuk na është bërë me dije ndonjë informacion konkret lidhur me menyrën se si është kryer ky bashkim dhe shkakun ligjor të tij.

Gjatë kohës që ankuesi ishte i izoluar (me liri të kufizuar) në ambientet e SPAK, atij i është kërkuar të dorëzojë aparatet telefonikë, në të kundërt ato do të sekuestroheshin. Ai nuk i kishte me vete aparatet telefonikë sepse sipas rregullave të vetë këtij institucioni, ato nuk lejohen. Për këtë arsye, i kishte

---

<sup>6</sup> Njoftim per shtyp SPAK dt. 14.12.2023.

lënë ato në një bar-kafe që ndodhet përballë godinës së SPAK (Bar-Kafe Class).

Pasi ankuesi ka refuzuar të tregojë burimin e informacionit, dhe gjatë kohës që mbahej i izoluar, po në datën 13.12.2023, nga organi i akuzës dhe GJKKO u ndërmorën një mori veprimesh procedurale ndaj tij, të cilat po i rendisim në mënyrë kronologjike si më poshtë vijon:

- Në orën 14:20 është marrë Vendimi nr. 500, datë 13.12.2023 i GJKKO, «Për lejimin e kontrollit te vendi i punës zyrat e TV Ora News dhe në banesën e tij»;
- Në orën 15:15 është marrë Vendimi nr. 501, datë 13.12.2023 i GJKKO, «Për lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik në vendin e punës dhe në banesën e tij»;
- Në orën 15:55 është marrë Vendimi nr. 502, datë 13.12.2023 i GJKKO, «Për lejimin e kontrollit personal»;
- Rreth orës 17:00 të datës 13.12.2023 atij iu komunikuan vendimet e cituara më sipër. Në zbatim të tyre iu bë kontrolli fizik personal. Pas ushtrimit të kontrollit iu sekuestrua në cilësinë e provës çelësi i automjetit personal Volkswagen Golf, me targa AA 883 ZZ. (*Procesverbali për sekuestrimin e sendeve, datë 13.12.2023, ora 17:43*);
- Rreth orës 17:30-18:00 u ushtrua kontroll i automjetit personal në prezencë të tij, por pa një vendim gjykate dhe pa prezencën e mbrojtësit, dhe/ose personit të besuar. Në automjet është sekuestruar vetëm një flash disk me ngjyrë të bardhë. (*Procesverbali për sekuestrimin e sendeve, datë 13.12.2023, ora 18:55*);
- Rreth orës 18:15, hetuesit së bashku me ankuesin janë drejtuar drejt banesës së këtij të fundit për të ushtruar kontrollin e banesës, i cili zgjati nga ora 18:30 deri 20:00. Kontrolli nisi pa praninë e mbrojtësit dhe/ose personit të besuar, në praninë e dy fëmijëve të mitur dhe të bashkëshortes së tij. Gjatë kontrollit, pas afro 30-45 minutash është përpjekur të vijë avokat Arben Llangozi, i njoftuar prej miqve të ankuesit, i cili pas

debatesh është pranuar të jetë prezent gjatë kryerjes së kontrollit deri në përfundimin e tij. Pas kontrollit të banesës u sekuestrua kompjuteri personal i ankuesit, një hard drive, 9 flash disqe, 4 kompakt disqe, një zarf me 54 fletë nga deklaratat e bashkëpunëtorit të drejtësisë në çështjen 75/2022, një aparat telefonik. (*Procesverbali për sekuestrimin e sendeve, datë 13.12.2023, ora 20:20*);

- Rreth orës 19:40 hetuesit janë paraqitur për kontroll në vendin e punës së ankuesit, në ambientet e Ora News. Kontrolli është zhvilluar pa praninë e avokatit të medias Ora News. Fillimisht është identifikuar cili është kompjuteri ku punonte ankuesi. Kontrolli ka zgjatur për rreth një orë. Në përfundim të tij janë sekuestruar kompjuteri i punës (njësia qendrore) në të cilin punonte ankuesi, një kompakt disk, një mandat arkëtimi për telefoninë celulare me disa shënime nga pas, dhe një letër tjetër me shënime. (*Procesverbali për sekuestrimin e sendeve, datë 13.12.2023, ora 22:30*);
- Rreth mesnatës, ndërmjet datës 13.12.2023 dhe 14.12.2023, u ushtrua kontroll në «Bar-Kafe Class» ku ankuesi kishte lënë dy aparatet telefonikë në banak përpara se të hynte në ambientet e SPAK. Kontrolli i lokalit dhe sekuestrimi i telefonave janë kryer pa një urdhër specifik gjykatë, megjithëse aparatet mbartin të dhëna elektronike;
- Në orën 01:00 të datës 14.12.2023, është kthyer çelësi i automjetit me procesverbal, duke u justifikuar që ky mjet nuk shërbente më për hetimin dhe ishte vendosur kthimi i tij. (*Procesverbali për kthimin e sendit (çelës automjeti) të sekuestruar, datë 14.12.2023, ora 01:00*).

Në datën 14.12.2023, SPAK ka publikuar një deklaratë për të gjitha veprimet e kryera më sipër.<sup>7</sup>

Shtetasi Elton Qyno i është drejtuar me kërkesë GJEDNJ për pezullimin e vendimit të GJKKO për nxjerrjen dhe përpunimin e të dhënave nga kompjuterat dhe telefonat e sekuestruara atij. Kjo Gjykatë me vendimin e

---

<sup>7</sup> Deklarata e SPAK, datë 14.12.2023, publikuar në faqen e internetit të SPAK.  
<https://spak.gov.al/deklarate-per-mediat-date-14-12-2023/>

datës 18.12.2023 ka vendosur mos pranimin e kësaj kërkesë si të pabazuar në qëllimin e nenit 39 të Rregullores së Gjykatës. Sipas Gjykatës, neni 39 zbatohet atëherë kur kërkuesi përballet me një rrezik të menjëhershëm dhe kur mund të pësojë dëme të pariparueshme, dhe se rastet më të shumta kur zbatohet ky nen kanë të bëjnë me procedurat e deportimit dhe ekstradimit, në rastet kur kërkuesi mund të ndodhet para një rreziku në shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën) dhe nenit 3 (e drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimit çnjerëzor) të KEDNJ në vendin ku do të kthehet.<sup>8</sup>

Në datën 18.12.2023 ankuesi, së bashku me personin juridik Ora News, i kanë paraqitur GJKKO një kërkesë për heqjen e sekuestros mbi sendet. Ndërkohë në të njëjtën datë, më 18.12.2023, ankuesi ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 501, datë 13.12.2023, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës së SPAK për sekuestrimin e të dhënave elektronike.

Në datën 27.12.2023, GJKKO vendosi të pranojë pjesërisht kërkesën e ankuesit për të kthyer sendet e sekuestruara, duke urdhëruar kthimin e flash diskut të gjetur në automjet (për shkak se kontrolli i automjetit u cilësua i paligjshëm), si dhe disa kompakt disqeve që sipas vetë SPAK, nuk kishin interes për hetimin (përmbanin muzikë ose filmime me festat familjare dhe të fëmijëve në kopsht).

Në datën 06.01.2024, Gjykata e Posaçme e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar vendosi rrëzimin e ankimit të shtetasit Elton Qyno duke miratuar Vendimin nr. 501, datë 13.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar «*Për lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik në vendin e punës dhe në banesën e tij*».

Ndërsa në datën 20.02.2024, Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, vendosi mos pranimin e rekursit të shtetasit Elton Qyno ndaj Vendimit nr. 501, datë 13.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Vendimit të datës 06.01.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

---

<sup>8</sup> Ndërkohë sqarojmë se në datën në të cilën është marrë vendimi nga GJEDNJ, gazetari Elton Qyno i ish-in sekuestruar sendet dhe materialet i ish-in marrë. Pra, Gjykata gjendej para faktit të kryer tashmë dhe gjendja e rrezikut të menjëhershëm kishte kaluar si dhe ardhja e pasojës kishte ndodhur.

Gjithashtu, me vendimin Nr. 60001-00123-00-2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit Nr. (24 987-2024-33) dt. 01.02.2024 të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe kthimin e çështjes për rigjykim tek i njëjti gjyqtar i kësaj gjykate.

Sqarojmë se në vendimet gjyqësore të cituara më sipër, nga gjykatat është vendosur në të tëra shkallët e gjykimit edhe ndalimi i publikimit të tyre e për këtë shkak, aksesit në to është i kufizuar. Avokati i Popullit nuk ka patur qasje në vendimin e Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe as në vendimet e Gjykatës së Lartë.

Vlen të theksojmë faktin se, sekuestrimi i pajisjeve dhe të dhënave të gazetarit Qyno në kundërshtim me standardet vendase dhe ndërkombëtare ka sjellë reagimin e organizmave ndërkombëtare, ndër të cilët edhe Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Procedura e Komunikimeve Individuale nën Protokollin Opsional (strukturë e OKB me seli në Gjenevë, Zvicër).

Në letrën e datës 17 Janar 2024, ndër të tjera Komiteti shprehet se në emër të z. Elton Qyno, është regjistruar rasti Nr. 4565/2024. *Në bazë të nenit 94 të rregullave të procedurës së Komitetit, Shtetit palë i është kërkuar të ndalojë kryerjen e çdo inspektimi, shpërndarjeje ose përpunimi gjyqësor të materialit të sekuestruar ankuesit, për sa kohë që çështja është nën shqyrtim nga Komiteti. Në këtë drejtim, Komiteti kërkoi nga Shteti palë të paraqesë observacione për masën pezulluese të kërkuar jo më vonë se 16 Shkurt 2024.*

Nga komunikimi me ankuesin Elton Qyno në vijimësi gjatë hetimit administrativ deri në hartimin e këtij raporti, nuk rezulton, që, përveç kthimit të çelësit të automjetit, një flash disku, disa kompakt disqeve dhe kompjuterit të punës, atij dhe medias Ora News t'i jenë kthyer pajisjet e sekuestruara në datat 13.12.2023-14.12.2023, që janë konkretisht: kompjuteri i shtëpisë, tre aparate telefonikë (njëri nga të cilët në përdorim të fëmijës së mitur të tij), një hard drive i jashtëm, disa flash disqe, disa kompakt disqe, si dhe dokumentet. Sqarojmë se deri më tani nuk ka deklarata të tjera të bëra nga SPAK në lidhje me ecurinë e veprimeve hetimore në këtë dosje të drejtuar ndaj personave që kanë nxjerrë sekretin në BKH apo SPAK.

**Vlerësimi i kryer nga Avokati i Popullit.**

## Konteksti i Lirisë së Shprehjes dhe Nevoja për Garantimin Efektiv të Saj

Liria e Medias është e garantuar nga aktet ndërkombëtare të detyrueshme për Shqipërisë dhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, respektivisht neni 22, paragrafi 1 e 2, ku parashikohet liria e shprehjes dhe ajo e shtypit (ushtrimi i profesionit të gazetarit), si dhe ligji “Për shtypin” nr. 7756, datë 11.10.1993, i ndryshuar.

Avokati i Popullit në vijimësi, në deklaratat dhe qëndrimet e tij publike, por edhe në disa rekomandime institucionale, është shprehur në mbrojtje të lirisë së shtypit dhe gazetarëve, si dhe të të drejtës së qytetarëve për të qenë të informuar në kohë reale për ngjarjet me ndjeshmëri dhe interes publik. Po ashtu, institucioni ynë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtave të gazetarëve e punonjësve të medias dhe ka ndërtuar një bashkëpunim të ngushtë me mediat edhe në kuadrin e “aleancës kundër gjuhës së urrejtjes”.

Në këtë kuadër vlerësojmë se është tepër e rëndësishme që institucionet shtetërore në përgjithësi t’ a respektojnë misionin informues të gazetarëve dhe sigurisht t’i japin fund kulturës së intimidimit apo sulmeve ndaj gazetarëve, pasi kultura e promovimit të kritikës konstruktive vetëm e rrit cilësinë e demokracisë në vend. **Nga ana tjetër, është e nevojshme që edhe komuniteti i medias të kuptojë rëndësinë e misionit të vet e ta ruajë atë në thelb duke refuzuar çdo tentativë shpërdorimi e keqpërdorimi.**

Rëndësia e këtyre të drejtave demonstron edhe nga moria e instrumenteve apo organizmave ndërkombëtare që e kanë trajtuar këtë problematikë. Gazetarët duhet të ndihen të sigurt për të punuar. Pa lirinë e medias, nuk ka shoqëri të lirë dhe demokratike. Liria e shprehjes dhe liria e medias janë ndër standardet kryesore me të cilat vlerësohet përparimi i vendeve kandidate drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në këtë kuadër, angazhimi i autoriteteve shqiptare duhet të garantojë dhe masat mbrojtëse në mënyrë që punonjësit e medias dhe gazetarët të punojnë në mjedise të sigurta. Në këto autoritete përfshihen jo vetëm autoritetet policore dhe administrata publike, por edhe prokuroria e gjykatat si dhe

agjenci të tjera që ushtrojnë veprimtari ligjzbatuese sikurse janë edhe SPAK e GJKKO.

Standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e gazetarëve dhe detyrimet pozitive për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (KE) rrjedhin nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që mbron gazetarët dhe lirinë e shprehjes, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe instrumente si Platforma për Mbrojtjen e Gazetarisë dhe Sigurinë e Gazetarëve, e njohur si një platformë partnere e Këshillit të Evropës

*“Paketa e Zgjerimit për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 për Shqipërinë tregon qartazi nevojën për të pasur zero tolerancë ndaj frikësimeve dhe kërcënimeve kundrejt gazetarëve dhe medias në rajon. Është thelbësore që gazetarët në Shqipëri të jenë të aftë ta bëjnë punën e tyre pa qenë të kërcënuar nga dhuna, sulmet apo intimidimet, për të siguruar që qytetarët kanë akses ndaj informacionit”,* thuhet në reagimin e KE.<sup>9</sup>

Gjatë prezantimit të Paketës së Zgjerimit 2022, fusha ku Shqipëria vlerësohet se **“nuk ka bërë përparim”**, është ajo e lirisë së shprehjes, ku theksohet se: *“... ndërthurja e interesave të biznesit dhe politikës vazhdoi të pengonte pavarësinë e medias dhe cilësinë e gazetarisë”*. Sipas raportit: *“Atmosfera e sulmeve verbale, fushatave të përbaltjes dhe akteve të intimidimit ndaj gazetarëve që raportojnë për sundimin e ligjit, korrupsionin dhe çështjet e drejtësisë, nuk janë përmirësuar.”* Po ashtu, theksohet se: *“... mbetet e rëndësishme të sigurohet që media të ketë qasje të drejtpërdrejtë dhe transparente në institucionet qeveritare dhe aktivitetet e tyre”<sup>10</sup>.*

Rekomandimet e sipërpërmendura kanë qenë të vlefshme edhe në Raportin e KE për Shqipërinë në vitin 2023<sup>11</sup>. Sipas tij, *“Vendi është në mes të një niveli të moderuar përgatitjeje në fushën e lirisë së shprehjes. Është bërë përparim i kufizuar, veçanërisht përmes amendamentit të Ligjit për mediat audiovizive,*

---

<sup>9</sup>Shih, <https://www.alb365.al/v1/2020/12/14/ke-denon-dhunen-ndaj-gazetareve-jo-sulme-dhe-intimidime/?fbclid=IWAR2IC7e3yYkZMWSVOVp95Z7jz5jYYBsmkB10NCEe-JCVv2J4A-vhGBJeiT8>

<sup>10</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en)

<sup>11</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda\\_23\\_5612](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_23_5612)

*për ta përafuar me Direktivën e BE-së të vitit 2018 për shërbimet e mediave audiovizive, me synimin për pjesëmarrje në Programin e Evropës Krijuese.*

*Megjithatë, ndërthurja e interesave të biznesit me ato politike, mungesa e transparencës së burimeve të financimit, përqendrimi i pronësisë së medias, frikësimi dhe kushtet e pasigurta të punës vazhduan të pengojnë pavarësinë e medias, pluralizmin dhe cilësinë e gazetarisë. Atmosfera e sulmeve verbale dhe fizike, fushatave të shpijjeve dhe padive për frikësim ndaj gazetarëve nuk është përmirësuar.”*

Sa i përket çështjes së shkeljes së të drejtave të gazetarëve në Shqipëri, qëndrim publik ka mbajtur edhe Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Znj. Dunja Mijatovic<sup>12</sup>. Ndonëse rasti ka qenë për një situatë të ndryshme, edhe në atë rast është trajtuar ndërveprimi midis të drejtës së informimit dhe të drejtës për rend e siguri. Kështu lidhur me përshkallëzimin e situatës gjatë protestave të qytetarëve të zhvilluara në dhjetor të vitit 2020, e cila ndër të tjera është shprehur se: “... është e shqetësuar në lidhje me ndalimin dhe sulmet e pretenduara ndaj disa gazetarëve që mbulojnë demonstratat.”<sup>13</sup>

Sipas znj. Mijatovic, “sulmet ndaj gazetarëve përbëjnë një shkelje serioze të lirisë së shtypit dhe të drejtës për t’u informuar. Autoritetet duhet të sigurojnë që gazetarët mund të vazhdojnë të informojnë qytetarët pa frikë nga kërcënimet ose aktet e dhunës”.

Ndërkohë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka shfaqur një sërë shqetësimesh lidhur me kufizimin e lirisë së medias në vendin tonë, duke përgatitur edhe disa raporte për këtë fushë.

---

<sup>12</sup> “Autoritetet shqiptare duhet të tregojnë përmbytje në menaxhimin policor të demonstratave dhe të sigurojnë hetime të hollësishme, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet e përdorimit të tepruar të forcës. Ndërsa e drejta për mbledhje paqësore mund të kufizohet për të mbrojtur shëndetin publik, autoritetet duhet të mbështesin parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në të gjitha rrethanat. Policia gjithashtu duhet të bëjë dallimin midis individëve të përfshirë në dhunë dhe atyre që demonstrojnë në mënyrë paqësore dhe të përbahen nga përdorimi i rëndë ose pa kriter i forcës.”

<sup>13</sup> Për më tepër, mund të shihet Deklarata e plotë e datës 16.12.2020 “**Albanian authorities must prevent further police violence and uphold the right to freedom of peaceful assembly**”.

<https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/albanian-authorities-must-prevent-further-police-violence-and-uphold-the-right-to-freedom-of-peaceful-assembly>



Ambasadori Bruce Berton, Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ka theksuar angazhimin e Prezencës për kauzën e lirisë së medias në vend. *“Është thelbësore që mediave t’u ofrohen mjetet dhe politikat institucionale për t’i ndihmuar ato që të lundrojnë në një mënyrë të përgjegjshme dhe etike në ekosistemin e informacionit që ndryshon me shpejtësi. Në përputhje me parimet e OSBE-së, të cilat qeveria është angazhuar që t’i zbatojë si një nga 57 shtetet tona pjesëmarrëse, institucionet publike shqiptare duhet t’i krijojnë medias hapësirën e nevojshme që të funksionojë pa pengesa. Për këtë arsye, i nxisim autoritetet që të kenë parasysh ruajtjen e ekuilibrit dhe të peshojnë me kujdes të drejtën për shpërndarjen e informacionit që është i rëndësishëm për publikun. Faktet duhen lënë gjithmonë të dalin në dritë, madje edhe ato që bëjnë thirrje për mbajtjen e përgjegjësisë apo që zbulojnë abuzime a korrupsion.”*<sup>14</sup>

*“Liria e shprehjes është fusha ku ne kemi parë më pak progres, dhe kjo mbetet një shqetësim për ne, mbetet shqetësim që ne e shohim në të gjithë rajonin në të njëjtën atmosferë të sulmeve verbale, të fushatave të njëjta dhe të sulmeve të gazetarëve që nuk janë përmirësuar dhe ky konteskt nuk ka hasur përmirësim. Ne shohim që ndërhyrja e biznesit në media e ndikon, pengon, krijon pengesa në cilësinë e gazetarisë dhe gazetarëve.”*

Teresa Ribeiro, përfaqësuesja e OSBE-së për lirinë e medias është shprehur në veçanti edhe për shuarjen e zërave kritikë. Qëndrim i njëjtë është mbajtur edhe nga opinioni i Komisionit të Venecias<sup>15</sup> lidhur me ndryshimet ligjore të kërkuara sa i takon mediave online, për të cilat janë dhënë rekomandime shumë të vlefshme sa i takon standardeve mbi bazën e të cilave mund të kushtëzohet liria e medias online dhe efekteve negative që mund të vijnë si rezultat i censurës në debatin e lirë dhe atë politik e informues në internet.

Sa më sipër përbën nevojën për kujdes të shtuar në lidhje me garantimin e të drejtës së shprehjes dhe trajtimin e kësaj të drejte me kujdes në ushtrimin e të drejtave të tjera nga autoritetet shtetërore apo ligjzbatuese.

---

<sup>14</sup> <https://www.osce.org/sq/presence-in-albania/552733>, datë 18.09.2023

<sup>15</sup> European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission Albania Opinion Nr. 980/2020 19 June 2020.

Avokati i Popullit vlerëson se presioni ndaj gazetarëve, fizik apo psikologjik, rrezikon të drejtën për integritet personal, jetën e tyre dhe lirinë e mendimit dhe të shprehjes. Gjithashtu, mungesa e kujdesit të duhur në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e të gjithë personave apo strukturave që janë përgjegjës, mund të rezultojë në një shkelje shtesë të të drejtave për akses në drejtësi dhe garancitë gjyqësore të të prekurve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Ushtrimi efektiv i këtyre të drejtave përfshin detyrime pozitive dhe negative për shtetet. Kështu, nëse njerëzit përballen me situata të cilat kanë ndjeshmëri të veçantë, dhe nuk janë ndërmarrë masa nga shtetet për të parandaluar veprimet që ndikojnë në ushtrimin e të drejtave, vetë shtetet mund të mbahen përgjegjës.<sup>16</sup>

Sa u përket detyrimeve negative, në zbatim të parimeve të së drejtës ndërkombëtare, shteti është përgjegjës për të gjitha aktet dhe veprimet në të cilat agjentët e tij marrin pjesë në ushtrimin e detyrave të tyre, përfshirë edhe rastet dhe situatën kur tejkalojnë kufijtë e autoritetit të tyre.<sup>17</sup>

Në respektim të lirisë së shprehjes, Zyra e Raportuesit Special të OKB-së për Lirinë e Opinioneve dhe Shprehjes ka theksuar rëndësinë e tre detyrimeve pozitive që burojnë nga të drejtat për jetën, integritetin personal dhe lirinë e shprehjes. Konkretisht, detyrimi për të parandaluar, detyrimi për të mbrojtur dhe detyrimi për të hetuar, provuar dhe ndëshkuar penalisht ata që janë përgjegjës për këto krime.<sup>18</sup> Sipas Zyrës së Raportuesit Special, këto detyrime janë plotësuese të njëra-tjetrës: në mënyrë që të jetë e lirë, e fortë dhe të ekzistojë debati i pakufizuar demokratik, dhuna ndaj gazetarëve duhet të luftohet përmes një politike gjithëpërfshirëse të parandalimit, mbrojtjes dhe ofrimit të drejtësisë.

---

<sup>16</sup> IACHR. Report on Citizen Security and Human Rights. OEA/Ser.L/V/II Doc. 57. December 31, 2009. Para. 38.

<sup>17</sup> I/A Court H.R. *Case of the "Mapiripán Massacre" v. Colombia*. Judgment of September 15, 2005. Series C No. 134. Para. 108; I/A Court H.R. *Case of the "Pueblo Bello Massacre" v. Colombia*. Judgment of January 31, 2006. Series C No. 140. Para. 111.

<sup>18</sup> United Nations (UN) Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) Representative on Freedom of the Media, Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression and African Commission on Human and Peoples' Rights (ACHPR) Special Rapporteur on Freedom of Expression and Access to Information. June 25, 2012. *Joint Declaration on Crimes Against Freedom of Expression*.

Zyra e Raportuesit Special ka theksuar po ashtu në vijimësi përgjegjësinë e zyrtarëve qeveritarë për të mbajtur vazhdimisht qëndrime publike që nuk i vënë gazetarët në rrezik të rritur të dhunës. Ai ka kujtuar, ndër të tjera, se masa e thjeshtë, por shumë efektive mbrojtëse përbëhet nga qëndrimet e autoriteteve më të larta të shtetit që njohin në mënyrë të qëndrueshme, të qartë, publike dhe të vendosur legjitimitetin dhe vlerën e profesionit të gazetarit, edhe kur informacioni i shpërndarë mund të rezultojë kritik ose i papërshtatshëm për interesat e qeverisë. Në mënyrë të ngjashme, është thelbësore që autoritetet të dënojnë me forcë sulmet e kryera kundër punonjësve të medias dhe inkurajojnë autoritetet kompetente të veprojnë me rigorozitet dhe shpejtësi për të hetuar ngjarje të tilla dhe për të ndëshkuar përgjegjësit e tyre.<sup>19</sup>

Sulmet kundër gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias përbëjnë shkelje veçanërisht serioze të të drejtave të njeriut, sepse ato synojnë jo vetëm individët, por privojnë të tjerët nga e drejta e tyre për të marrë informacion, duke kufizuar kështu debatin publik, i cili është në zemër të demokracisë pluraliste. Në përgjigje të nivelit alarmant dhe të papranueshëm të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të medias në Evropë, dhe duke patur parasysh efektin dëmtues në funksionimin e shoqërisë demokratike, në Prill 2016, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin CM/Rec (2016) 4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias.<sup>20</sup>

Rekomandimi është instrumenti i vetëm ndërkombëtar që siguron udhëzime shteruese për shtetet anëtare për të vepruar në fushat e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale, promovimit të informacionit, edukimit dhe ngritjes së vetëdijes me synimin për të siguruar mbrojtjen efektive të gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe aktorët e medias.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias, jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në një rrezik real dhe të menjëhershëm, duhet të kenë qasje të menjëhershme në autoritetet e zbatimit të ligjit dhe/ose në një mekanizëm të veçantë

---

<sup>19</sup> Annual Report 2010. Office of the Special Rapporteur for Freedom of Expression.

<sup>20</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pranuar në mënyrë të përsëritur që individë, organizata të shoqërisë civile, sinjalizues dhe akademikë, përveç gazetarëve profesionistë dhe medias, të gjithë mund të japin kontribute të vlefshme në debatin publik, duke luajtur kështu një rol të ngjashëm ose ekuivalent me atë të luajtur tradicionalisht nga media e institucionalizuar dhe gazetarët profesionistë.

mbrojtjeje/sigurie. Dialogu midis autoriteteve shtetërore dhe organizatave të gazetarëve, inkurajohet për më tepër për të shmangur fërkimet ose përplasjet midis policisë dhe anëtarëve të medias.

Duke patur parasysh rolin thelbësor të gazetarëve në përcjelljen e informacionit për publikun dhe mbajtjen e përgjegjësisë nga autoritetet, veçanërisht në kontekste të ndjeshme, është e domosdoshme që autoritetet shtetërore të mos ndërhyjnë në mbulimin nga ana e medias të ngjarjeve që kanë implikime të rëndësishme për funksionimin e sistemeve demokratike. Si rrjedhojë, gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias kanë të drejtë të fotografojnë/demonstrojnë filmime, duke përfshirë trajtimin policor të trazirave dhe se ***pajisjet e tyre nuk duhet të sekuestrohen.***

Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të jenë të vëmendshme ndaj shenjave dhe kredencialeve gazetareske. Për më tepër, mungesa e tyre nuk duhet të përdoret si pretekst për kufizime të padrejta në aktivitetet gazetareske. Kur gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias nuk janë në gjendje të prodhojnë dokumentacion që tregon statusin e tyre, autoritetet duhet të përpiqen t'a verifikojnë atë me mjete të tjera, për shembull, duke konsultuar organizata të besueshme mediatike dhe organizata profesionale të gazetarëve që mund të konfirmojnë statusin e gazetarit. Trajnimi/dialogu i koordinuar midis medias dhe policisë është i rëndësishëm për të kuptuar përgjegjësitë dhe kufizimet e njëri-tjetrit dhe për këtë arsye sigurojnë besim dhe marrëdhënie të mira pune.

Në Shqipëri mediat dhe komunikimet në të gjitha fushat, iu nënshtruan një evolucioni të konsiderueshëm. Marrëdhënia në mes të publikut dhe informacionit ka ndryshuar. Zhvillimi i medias në internet dhe rrjetet sociale tani gjeneron një rrjedhë të vazhdueshme informacioni në të cilën publiku dhe media duhet të drejtohen. Individët nuk kërkojnë informacion vetë; ata presin që informacioni t'ju vijë. Po ashtu, nocioni i “publikut” ka evoluar: sigurimi i aksesit të publikut në gjykatë nuk perceptohet më si i mjaftueshëm për të marrë një vendim “publik”. Qenia e ekzistencës publike nënkupton aksesueshmërinë, e cila nga ana e saj kërkon sjelljen e informacioneve të thjeshta, të kuptueshme dhe të sakta për një gamë sa më të gjerë të individëve dhe gjyqtarët dhe prokurorët duhet të garantojnë kryerjen e proceseve në pajtim me parimin e shtetit ligjor, prezumimin e pafajësisë, gjykimin e drejtë dhe rregullin se drejtësia jepet vetëm nga gjykata, por duke respektuar jo

vetëm këto detyrime procedurale, por edhe disa të drejta të tjera që jo domosdoshmërisht janë pjesë integrale e detyrës së tyre funksionale të përditshme.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit vlerëson të theksojë se për vetë natyrën e saj, e drejta e shprehjes dhe liria e medias duhet trajtuar me kujdes të veçantë, pasi ato janë vlera themelore në një shoqëri demokratike. Çdo ndërhyrje në këto të drejta duhet të jetë thelbësisht proporcionale dhe minimale. Për këtë GJEDNJ ka një jurisprudencë të gjerë dhe trajtim të qarte të 3 testeve që vlerësojnë proporcionalitetin e ndërhyrjes. Kjo qasje duhet të zbatohet edhe në sistemin e brendshëm.

### Pavarësia e organeve të Prokurorisë dhe Gjykatës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon Prokurorinë si një organ kushtetues me funksion të pavarur<sup>21</sup>, pa e përfshirë atë konkretisht në ndonjërin nga pushtetet, por që është e organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor. Pavarësia e këtij organi parashikohet edhe në nenin 25, pika 2<sup>22</sup> e Kodit të Procedurës Penale. Kushtetuta rregullon në vija të përgjithshme funksionin dhe organizimin e prokurorisë në një pjesë të veçantë të saj. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq, në emër të shtetit. Ndërkohë Kushtetuta parashikon se, ushtrimin e

---

<sup>21</sup> Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se:

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.

3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.

<sup>22</sup> Neni 25

1. Funksionet e prokurorit ushtrohen:

a) në hetimet paraprake dhe në gjykimet e shkallës së parë, nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë;

b) në gjykimet e çështjeve të ankimuara, nga prokurorët pranë gjykatave të apelit dhe pranë Gjykatës së Lartë.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij prokurori është i pavarur. Rregullat për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga prokurori parashikohen në ligj.

3. Për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

kompetencave të tyre, prokurorët e kryejnë sipas ligjit. Një sërë detyrash të tjera i caktohen organit të prokurorisë me ligj.

Ndërsa në nenin 145/1<sup>23</sup> të Kushtetutës parashikohet se: *“Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”*. Parimi i Shtetit të së Drejtës është i lidhur ngushtë me mirëfunksionimin e pavarur të pushtetit gjyqësor, i cili si një prej funksioneve të shtetit, garanton mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e akteve normative të vendosura si rezultat i funksionit ligjvënës. Pushteti gjyqësor është një garanci për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës.

Mbarëvajtja e këtij procesi është e lidhur ngushtë me pavarësinë e pushtetit gjyqësor, e cila përbën kushtin themelor për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës. Ndërkohë, parimi i shtetit të së drejtës në lidhje me atë të ndarjes së pushteteve, nënkupton garantimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut.

Jurisprudenca e Gjykatës sonë Kushtetuese, në lidhje me zbatimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, si dhe të parimit të shtetit të së drejtës, ka theksuar se pavarësia e gjyqësorit duhet kuptuar në disa aspekte. Në radhë të parë, duhet kuptuar si pavarësi thelbësore, pra një tagër e gjykatave për të dhënë vendime me paanësi dhe pa u ndikuar nga interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit; në radhë të dytë, si pavarësi strukturore, që kërkon parashikimin në Kushtetutë të institucionit që realizon emërimet dhe shkarkimet e gjyqtarëve; në radhë të tretë, si pavarësi organizative dhe financiare, e cila në vetvete përbën një pjesë të pavarësisë strukturore.

*“Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një nga parimet themelore të shtetit demokratik, por nuk përbën një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut... Në këtë kuptim, kjo pavarësi nuk është një privilegj, por një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të*

---

<sup>23</sup> Neni 145

1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

2. Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.

3. Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit.

*drejtat e njeriut për të pasur një arbitër të paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta...”.<sup>24</sup>*

Pavarësia e brendshme e gjykatave ka qenë objekt shqyrtimi edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila duke interpretuar nenin 145 të Kushtetutës, (“gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”), ka theksuar se: “...Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. Askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë”.<sup>25</sup>

**Por, pavarësia e prokurorëve dhe e gjyqtarëve nuk presupozon që ata të mos mbajnë përgjegjësi në kryerjen e funksioneve të tyre.** Kështu, ata janë të përgjegjshëm penalisht nëse kryejnë një vepër penale gjatë kryerjes së detyrës.

**Kur nuk është fjala për vepra penale, ata i nënshtrohen procedimit disiplinor nga organet kompetente.** Gjithashtu, ata nuk janë të përjashtuar as nga përgjegjësia civile në rrethana mjaft të përcaktuara, në kushtet kur qytetari që është dëmtuar financiarisht nga një qëndrim i fajshëm i prokurorit apo gjyqtarit, mund të kërkojë dëmshpërblimin e dëmeve nga këta subjekte të posaçëm.

Togfjalëshi në nenin 145/2 të Kushtetutës (për gjyqtarët) se ... “u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”, ai në nenin 148/2 të Kushtetutës (për prokurorët) ... “garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit” dhe ai në nenin 25/2 të K.Pr.Penale “Rregullat për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga prokurori parashikohen në ligj”, nuk lënë asnjë hapësirë për diskutim lidhur me faktin e pavarësisë së organeve të prokurorisë ashtu edhe të gjykatës. Këto organe janë të detyruara që t’u nënshtrohen e të zbatojnë me korrektësi, objektivitet dhe paanësi Kushtetutën dhe ligjin, pasi këtu mbaron pavarësia e tyre. Në këtë kuptim, përgjegjësia e

<sup>24</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, Nr. 25, Viti 2008

<sup>25</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, Nr. 11/2004.

tyre për zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit përbën edhe kufijtë e pavarësisë së tyre.

Neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon, se *sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.*

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj në disa vendime, duke iu referuar nenit 7 të Kushtetutës ka theksuar se ky parim, në demokraci, si formë e qeverisjes, *synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij.*

Sipas Gjykatës Kushtetuese, *parimi i ndarjes së pushteteve nuk duhet kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes garantohet vetëm nëpërmjet sistemit të kontrolleve dhe ekuilibrave. Në këtë mënyrë, sipas Kushtetutës, aq sa flitet për ndarje bëhet fjalë edhe për ekuilibër të pushteteve. Qëllimi i një koncepti të tillë kushtetues siguron që të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollat dhe ekuilibrat që njeh Kushtetuta, i japin secilës degë, pushtete që kompensojnë apo zbusin ato të degëve të tjera. Ekzistojnë mjete apo mekanizma që balancojnë pushtetet, sepse në analizë të fundit asnjë pushtet në vete nuk është në gjendje të përmbushë misionin, nëse veprimtaria e tij nuk harmonizohet me veprimtarinë e pushteteve të tjerë dhe nëse nuk sigurohet një ekuilibër, bashkërendim dhe kontroll reciprok që natyrisht nuk ndërhyjnë në atë masë sa të dëmtojnë misionet e tyre kushtetuese*<sup>26</sup>.

Sjellim në vëmendje se në nenin 31<sup>27</sup> të ligjit organik të Avokatit të Popullit, janë parashikuar 5 seksionet e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe fusha e

<sup>26</sup> Vendimet nr. 11, datë 27.05.2004 dhe nr. 5, datë 05.02.2014

<sup>27</sup> Në nenin 31 parashikohet se:

“Zyra e Avokatit të Popullit ndahet në pesë seksione të specializuara, në krye të të cilave vendosen komisionerët.

Këto seksione janë:

1. Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.
2. Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.
3. Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës.
4. Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.



veprimtarisë së tyre. Njëri prej këtyre seksioneve është edhe ai *për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.*

Ndërsa në nenin 25<sup>28</sup> të këtij ligji “Personat dhe aktet jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit”, në paragrafin e fundit parashikohet se, *Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.*

**Pra, referuar këtyre parashikimeve ligjore, rezulton se Avokati i Popullit ka mandat edhe ndaj pushtetit gjyqësor dhe se pranimi e hetimi i ankesave, kërkesave ose njoftimeve për shkelje të të drejtave të njeriut, nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve, por i referohen në mënyrë specifike respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.**

Ky argument potencialisht në këtë raport përgjithësues, është në favor të qëndrimit se Avokati i Popullit brenda kompetencës që Kushtetuta dhe ligji organik i ka caktuar, ka të drejtë të marrë në shqyrtim ankesën e ushtruar nga gazetari Elton Qyno, vetëm përse i përket shkeljes së të drejtave të njeriut për këtë ankues, pa u përfshirë në vlerësimin e themelit apo përmbajtjes së vendimeve gjyqësore apo veprimeve procedurale të nxjerra ndaj tij, në mënyrë që nëpërmjet këtij raporti, të vendoset një standard kushtetues lidhur me disa elemente procedurale që i përkasin kësaj ankese në kushtet kur Avokati i Popullit vlerëson se të drejtat e njeriut, janë e duhet të mbeten në qendër të çdo veprimtarie shtetërore.

---

5. Seksioni i përgjithshëm...”.

<sup>28</sup> Në nenin 25 parashikohet se:

Janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit personat dhe aktet e mëposhtme:

a. Presidenti i Republikës

b. Kryetari i Këshillit të Ministrave

Gjithashtu, janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit:

b. Urdhërat me karakter ushtarak të Forcave të Armatosura.

Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

## Konstatime gjatë shqyrtimit të ankesës së gazetarit Elton Qyno.

Paraprakisht sqarojmë edhe një herë se institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me mandatin e vet kushtetues, nuk ka objekt të punës së tij e si rrjedhojë edhe të këtij hetimi administrativ që të vlerësojë e çmojë vendimet e marra nga strukturat e SPAK dhe GJKKO ndaj gazetarit Elton Qyno në rastin objekt shqyrtimi. Megjithatë, lidhur me respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe të standardeve më të mira të parashikuara në Kushtetutë, aktet ndërkombëtare dhe qëndrimet e mbajtura nga organizmat rajonale e ndërkombëtarë, pjesë e të cilëve është edhe vendi ynë, nuk mund kurrsesi të qëndrojmë indiferent kur konstatojmë cenimin e tyre.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit vlerëson punën e SPAK dhe GJKKO si dy institucione të krijuara për të përballuar plot vështirësi e sfida për goditjen e korrupsionit dhe krimin të organizuar në vendin tonë. Këto fenomene për disa dekada janë bërë shqetësim serioz për shoqërinë shqiptare dhe integrimin e vendit tonë në BE.

Tashmë brenda pak viteve nga krijimi dhe funksionimi i këtyre strukturave kushtetuese të reja, kemi statistika domethënëse. Këto statistika janë tregues i mirëfunksionimit dhe pavarësisë së tyre për goditjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë së funksionarëve që shkelin ligjin dhe abuzojnë me detyrën dhe i kthimit të besimit publik te sistemi i drejtësisë. Por gjithashtu është e domosdoshme që kjo veprimtari hetimore e gjyqësore, të kryhet në përputhje me aktet normative në fuqi dhe duke garantuar respektimin e të drejtave të njeriut gjatë procesit penal.

Avokati i Popullit çmon që nëpërmjet këtij raporti përgjithësues të vërë theksin mbi disa problematika që i përkasin disa elementëve të të Drejtave të Njeriut të garantuara në nivel kushtetues e konventor, për të cilat parashikimi në Kodin e Procedurës Penale, ose mënyra e interpretimit të këtyre parashikimeve nuk jep garanci të mjaftueshme ose të kënaqshme.

Komunikimi i organit të akuzës me palët e përfshira në një hetim penal dhe marrja në pyetje e tyre.

Në lidhje me mënyrën e thirrjes në ambientet e SPAK të këtij gazetari konstatojmë se, në disa dispozita të K.P.Penale<sup>29</sup> janë parashikuar organet,

<sup>29</sup> Neni 132 Organet dhe format e njoftimeve

1. Njoftimet e akteve bëhen nga ftuesi gjyqësor ose nëpërmjet shërbimit postar.
2. Gjyqtari, kur e çmon të nevojshme, mund të urdhërojë që njoftimet të bëhen nga policia gjyqësore.
3. Kur kopja e aktit i dorëzohet të interesuarit nga ana e sekretarisë së gjykatës, ajo ka vlerën e njoftimit. Në këtë rast sekretari i gjykatës bën shënim në aktin original për dorëzimin dhe për datën.
4. Njoftimet që u bëhen nga gjykata të interesuarve në praninë e tyre shënohen në procesverbal.

Neni 133 Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike

1. Gjykata në raste të ngutshme mund të urdhërojë që personat e kërkuar nga palët, përveç të pandehurit, të lajmërohen me telefon nga sekretaria e gjykatës ose nga policia gjyqësore. Në origjinalin e lajmërimit shënohet numri i telefonit të kërkuar, emri dhe detyra që kryen personi që merr njoftimin, marrëdhëniet e tij me atë që njoftohet, data dhe ora e telefonatës.
2. Njoftimi me telefon ka vlerë nga çasti kur është bërë, me kusht që të dokumentohet marrja e tij.
3. Shfuqizuar.
4. Gjykata, kur e çmon të përshtatshme, përveç të pandehurit, mund të disponojë njoftimin e personit, me mjete të tjera teknike që garantojnë njoftimin, me kusht që të dokumentohet marrja e tij.
5. Njoftimi i dëshmitarit me identitet të fshehur, dëshmitarit të mbrojtur dhe bashkëpunëtorit të drejtësisë bëhet nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit prokurorit.

Neni 134 Njoftimi i akteve të prokurorit

1. Njoftimi i akteve të prokurorit, gjatë hetimeve paraprake, bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar, në format e parashikuara nga neni 133.
2. Dorëzimi i kopjes së aktit të interesuarit nga ana e sekretarisë ka vlerën e njoftimit. Dorëzuesi shënon në origjinalin e aktit faktin e dorëzimit dhe datën.
3. Lajmërimet e bëra verbalisht nga prokurori zëvendësojnë njoftimet, me kusht që ky fakt të shënohet në procesverbal.

Neni 143 Pavlefshmëria e njoftimeve

1. Njoftimi është i pavlefshëm:
  - a) kur akti është njoftuar jo i plotë, me përjashtim të rasteve kur ligji lejon njoftimin me ekstrakt;
  - b) kur në kopjen e aktit të njoftuar mungon nënshkrimi i atij që ka bërë njoftimin;
  - c) kur janë shkelur dispozitat e veçanta mbi personin të cilit duhet t'i dorëzohet kopja;
  - ç) kur nuk është bërë afishimi i njoftimit për të pandehurin në gjendje të lirë;
  - d) kur në origjinalin e aktit të njoftuar mungon nënshkrimi i personit që ka marrë përsipër njoftimin, sipas nenit 140 paragrafi 1;
  - dh) kur nuk janë respektuar format për njoftimin me mjete teknike të veçanta dhe që për këtë shkak ai që duhej njoftuar nuk ka ardhur në dijeni të aktit.

Neni 308 Ftesa për paraqitje

1. Prokurori fton personin ndaj të cilit zhvillohen hetime të paraqitet kur do ta marrë në pyetje ose kur duhet të kryejë veprime që kërkojnë praninë e tij.
2. Ftesa për t'u paraqitur përmban:
  - a) gjeneralitetet ose të dhëna të tjera personale që vlejné për identifikim;
  - b) ditën, orën dhe vendin e paraqitjes;
  - c) llojin e veprimit për të cilin është ftuar;
  - ç) paralajmërimin se prokurori mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm në rast mosparaqitje, pa pasur pengesë të ligjshme.
  - d) letrën e të drejtave në formë të shkruar, sipas nenit 34/a të këtij Kodi.
3. Ftesa përmban edhe parashtrimin e përmbledhur të faktit që rezulton nga hetimet e bëra deri në atë çast.
4. Ftesa njoftohet të paktën tri ditë para asaj që është caktuar për paraqitje, me përjashtim të rasteve të ngutshme.

Neni 312 Marrja e të dhënave

1. Prokurori merr të dhëna nga personi i dëmtuar dhe nga ata që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, duke zbatuar rregullat e caktuara për marrjen e dëshmisë.
2. Thirrja e këtyre personave bëhet me urdhër, i cili përmban:

mjetet dhe format e njoftimeve nga prokurori dhe gjykata për të marrë të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, personi i dëmtuar dhe nga ata që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit.

Sipas këtyre dispozitave, organet e njoftimit janë ftuesi gjyqësor, shërbimi postar dhe policia gjyqësore. Ndërsa forma e njoftimit të këtyre subjekteve si rregull bëhet me ftesë për paraqitje, e cila duhet të përmbajë gjeneralitetet ose të dhëna të tjera personale që vlejnë për identifikim; ditën, orën dhe vendin e paraqitjes; llojin e veprimit për të cilin është ftuar; paralajmërimin se prokurori mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm në rast mosparaqitje, pa patur pengesë të ligjshme; letrën e të drejtave në formë të shkruar, sipas nenit 34/a të këtij Kodi; parashtrimin e përmbledhur të faktit që rezulton nga hetimet e bëra deri në atë çast si dhe afatin e njoftimit, të paktën tri ditë para asaj që është caktuar për paraqitje, me përjashtim të rasteve të ngutshme (neni 308 i K.Pr.P).

Në nenin 133 të K.P.Penale është parashikuar edhe rasti i njoftimeve të veçanta dhe me mjete të tjera teknike. Sipas kësaj dispozite, organi procedues mund të urdhërojë që personat të lajmërohen me telefon nga sekretaria ose nga policia gjyqësore. Ndërkohë në këtë nen është parashikuar edhe procedura që duhet të zbatohet në të tilla raste, si: në origjinalin e lajmërimit shënohet numri i telefonit të kërkuar, emri dhe detyra që kryen personi që merr njoftimin, marrëdhëniet e tij me atë që njoftohet, data dhe ora e telefonatës. Njoftimi me telefon ka vlerë nga çasti kur është bërë, me kusht që të dokumentohet marrja e tij. Po ashtu, organi procedues mund të disponojë njoftimin e personit, me mjete të tjera teknike që garantojnë njoftimin, me kusht që të dokumentohet marrja e tij.

Referuar ankesës së ushtruar pranë Avokatit të Popullit, në rastin e gazetarit Elton Qyno është zbatuar neni 133 i K.P.Penale, duke e njoftuar atë nëpërmjet

---

a) gjeneralitetet e personit;

b) ditën, orën dhe vendin e paraqitjes;

c) paralajmërimin se prokurori mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm në rast mosparaqitje pa patur pengesë të ligjshme.

3. Prokurori urdhëron në të njëjtën mënyrë edhe për thirrjen e përkthyesit dhe ekspertit.

4. Thirrja bëhet të paktën tre ditë përpara ditës së paraqitjes, me përjashtim të rasteve të ngutshme.

telefonit, por ne nuk kemi informacion nëse nga SPAK është respektuar me përpikmëri procedura e parashikuar në këtë dispozitë.

**Ndërkohë, konstatojmë se arsyeja e thirrjes së këtij shtetasi në ambientet e SPAK nuk ka qenë korrekte.** Ndonëse i është thënë që të paraqitej për t'u njohur me një urdhër ndalimi për mospublikimin e informacioneve, në fakt ai është thirrur e është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për disa akte hetimore që i përkasin çështjes penale nr. 75, të vitit 2022, të cilat përbëjnë sekret hetimor. Po ashtu ai është mbajtur në godinën e SPAK për rreth 7 orë.

Duke vlerësuar komunikimin dhe bashkëpunimin në lidhje me këtë çështje, Avokati i Popullit çmon se nga rrethanat dhe vlerësimi tërësor i tyre, arrihet në një rezultat tjetër. **Konkretisht nuk ka asnjë arsye tjetër të vlefshme për të justifikuar nevojën e 7 orëve pyetje për një çështje të kufizuar që nuk ka e s'mund të ketë nevojë për sqarime të kësaj natyre.** As në komunikimin zyrtar nuk shpjegohet fakti i mbajtjes së ankuesit për 7 orë në zyrat e këtij organi, për një çështje që nuk rezulton se ka nevojë për kohë të gjatë për t'u sqaruar. Ndërkohë, sjellim në vëmendje që sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, **asnjë person si në cilësinë e personit nën hetim apo që ka dijeni për rrethanat e hetimit nuk mund të detyrohet të japë deklaratime<sup>30</sup>.**

<sup>30</sup> Neni 311 i KPrP “Marrja në pyetje e personit të pandehur në një procedim të lidhur” parashikon:

1. Personi i marrë si i pandehur në një procedim të lidhur merret në pyetje nga prokurori në format e parashikuara nga neni 167.

Neni 167 i KPrP “Pyetja e një personi të marrë si i pandehur në një procedim të lidhur” parashikon se:

1. Personat e marrë si të pandehur në një procedim të lidhur, ndaj të cilëve procedohet ose është proceduar veç e veç, pyeten me kërkesën e palës ose edhe kryesisht.

2. Ata janë të detyruar të paraqiten në gjykatë, e cila, kur është e nevojshme, urdhëron shoqërimin e tyre forcërisht. Zbatohen dispozitat për thirrjen e dëshmitarëve.

3. Personat e treguar në paragrafin 1 ndihmohen nga mbrojtësi i zgjedhur dhe në mungesë të tij nga një mbrojtës i caktuar kryesisht.

4. Para se të fillojë pyetja, gjykata i njofton personat e treguar në paragrafin 1 se kanë të drejtë të mos përgjigjen....

5. Dispozitat e paragrafëve të mësipërm zbatohen edhe gjatë hetimit paraprak ndaj personave të marrë si të pandehur për një vepër penale të lidhur me atë për të cilën procedohet.

Neni 297 i KPrP “Marrja e të dhënave të tjera” parashikon se:

1. Policia gjyqësore merr të dhëna nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit.

2. Zbatohen dispozitat e neneve 155 deri 160.

3. Nëse të dhënat duhet të merren nga një i mitur, duhet të sigurohet prania e prindit ose kujdestarit, ose e një personi të rritur, të zgjedhur nga i mituri, si dhe prania e psikologut.

Neni 159 i KPrP “Ruajtja e sekretit profesional” parashikon se:

Avokati i Popullit në vijimësi ka trajtuar çështjen e përdorimit proporcional të së drejtës për marrjen në pyetje të personave dhe dokumentimit të kësaj procedure në mënyrë korrekte. Pavarësisht standardeve të kërkuara në mënyrë të vazhdueshme, seancat e marrjes në pyetje nuk regjistrohen në kamera apo/dhe audio. Duke qenë se mbrohen nga sekreti hetimor, Avokati i Popullit nuk ka mundur të shqyrtojë dhe vlerësojë procesverbalet e marrjes në pyetje të këtij shtetasi, për të parë nëse nga përmbajtja e tyre justifikohet pyetja e pandërprerë për 7 orë qëndrim e Z. Qyno në ambientet e SPAK apo jo, por kjo mund të bëhet në kuadër të vlerësimit të brendshëm nga vetë organi procedues.

Nën optikën e Avokatit të Popullit, vendosja e personave dhe marrja e tyre në pyetje duhet të bëhet për atë sa është nevoja e hetimit dhe të mos demonstron ushtrim presioni ndaj çdo personi apo trajtim të papërshtatshëm të tij. Avokati i Popullit vlerëson se të gjitha organet ligjzbatuese, gjatë marrjes në pyetje, duhet të sigurojnë trajtim të përshtatshëm dhe se kjo është një sfidë për ta, por edhe karakteristikë e përgjithshme e çdo sistemi të shtetit të së drejtës që ka në bazë të drejtat e njeriut.

Po ashtu, aftësia dhe mundësia për të hedhur poshtë çdo provë apo pretendim të personave për trajtim të papërshtatshëm nga organet ligjzbatuese, është thelbësore për të ruajtur besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë por edhe më gjerë.

Është rasti të sjellim në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Avokati i Popullit në rekomandimet dërguar strukturave vendore e qëndrore të Policisë së Shtetit lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë

---

1. Nuk mund të detyrohen të dëshmojnë për sa dinë për shkak të profesionit, me përjashtim të rasteve kur kanë detyrimin që t'ua referojnë autoriteteve proceduese:

- a) përfaqësuesit e besimeve fetare, statutet e të cilëve nuk janë në kundërshtim me rendin juridik shqiptar;
- b) avokatët, përfaqësuesit ligjorë dhe noterët;
- c) mjekët, kirurgët, farmacistët, obstetrët dhe kushdo që ushtron një profesion shëndetësor;
- ç) ata që ushtrjnë profesione të tjera, të cilëve ligji u njeh të drejtën të mos dëshmojnë për ato që lidhen me sekretin profesional.

2. Gjykata, kur ka arsye të dyshojë se pretendimi i bërë nga këta persona për t'iu shmangur dëshmisë nuk ka baza, urdhëron verifikimet e nevojshme. Kur ai rezulton pa baza, gjykata urdhëron që dëshmitari të deponojë.

3. Dispozitat e parashikuara nga paragrafi 1 dhe 2 zbatohen edhe për gazetarët profesionistë lidhur me emrat e personave nga të cilët ata kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Por, kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij

gjqësore me shtetasit. Nga inspektimet e bëra nga strukturat e institucionit tonë, është konstatuar se ambientet ku kryhen këto veprime nuk janë të monitoruara me kamera për vëzhgimin e veprimeve procedurale të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit në vijimësi i ka rekomanduar organeve të Policisë së Shtetit marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra. Ky sistem monitorimi, do t'i shërbente më së miri provueshmërisë së çdo veprimi procedural dhe fizik që kryhet gjatë marrjes në pyetje të këtyre shtetasve nga organi ligjzbatues, për të minimizuar çdo akt fizik apo psikologjik të papërshtatshëm, që mund të kryhet në dëm të personave të ndaluar.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare<sup>31</sup>, e konsideron procesin e monitorimit filmik (**audio-vidio**), një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë gjyqësore.

Nëse nga oficerët e policisë gjyqësore të SPAK do të ishte bërë monitorimi i veprimeve procedurale të kryera me shtetasin Elton Qyno në ambientet e këtij organi, do të krijohej mundësia e sqarimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të pretendimeve të ankuesit por edhe të qëndrimit të SPAK në informacionin e dërguar institucionit tonë, në kushtet kur ankuesi e organi procedues kanë qëndrime të ndryshme sa i përket këtij fakti.

Në përfundim, në lidhje me këtë çështje, Avokati i Popullit vlerëson se nga të gjitha rrethanat **nuk rezulton e justifikuar kohëzgjatja prej 7 orësh në godinën e SPAK e qëndrimit të ankuesit,** përveçse me qëllim për t'a

---

<sup>31</sup> "Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; **kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video).** Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste." CPT' reports; Armenia: Visit 2010ëpar.18]

mbajtur dhe izoluar ndërsa merreshin masat e tjera që do të vlerësoheshin ndaj tij.

Nga ana tjetër, sqarojmë se, SPAK në përgjigjen e dërguar institucionit tonë parashtron se, që në datën 14.06.2022, gazetarit në fjalë i është komunikuar urdhërimi për mos publikimin e akteve procedurale të procedimit penal nr. 75/2022. Ndërsa nga aktet e dërguara nga ankuesi të cilat janë administruar nga ana jonë, respektivisht Urdhri i SPAK i datës 14.06.2022 «*Për ruajtjen e sekretit, ndalimin e publikimit të akteve dhe përmbajtjes së tyre*», rezulton se ai nuk është nominativ por i përgjithshëm për median dhe i është dërguar redaksisë ku punon ankuesi e jo atij personalisht. Gjithashtu nga përmbajtja e këtij urdhëri, rezulton se ndalohet publikimi i deklaramëve të dhëna gjatë hetimit nga ana e shtetasve Henrik Hoxhaj dhe Nuredin Dumani në kuadër të procedimit penal nr. 75 të vitit 2022 në cilësinë e bashkëpunëtorit të drejtësisë apo si person ndaj të cilit zhvillohen hetime deri në përfundim të hetimeve.

Pas nxjerrjes së këtij urdhëri, ankuesi nuk ka publikuar asnjë deklaratë të dhënë gjatë hetimit nga bashkëpunëtori i drejtësisë dhe personi nën hetim. Megjithatë hetimet e këtij procedimi penal përfunduan dhe në datën 09.08.2023 dosja nr. 75/2022 ka shkuar në gjykatë. Gjithashtu, rezulton se në këtë Urdhër nuk është parashikuar ndalimi i publikimeve të bisedave të bëra ndërmjet anëtarëve të grupit të strukturuar kriminal në aplikacionin SkyECC. Ky ndalim është parashikuar në deklaratën e bërë para SPAK nga ankuesi në datën 13.12.2023, kopjen e të cilës na e ka dërguar së bashku me ankesën. Ndërkohë theksojmë se publikimi në faqen e internetit të medias Ora News TV i bisedave ndërmjet anëtarëve të grupit të strukturuar kriminal në aplikacionin SkyECC është bërë në datën 10.12.2023, pra, para nënshkrimit të deklaratës, më dt.13.12.2023. Ndërsa pas kësaj date, ankuesi nuk ka publikuar materiale procedurale nga kjo dosje apo të bisedave të realizuara në aplikacionin SkyECC nga anëtarët e këtij grupi.

Karta e të Drejtave dhe komunikimi i saj personave palë në procesin penal.

Personat e dyshuar dhe të akuzuar kanë të drejtën për t'u informuar për të drejtat e tyre përfshirë atë për t'u mbrojtur me avokat, të drejtën për ndihmë juridike falas dhe mënyrat për t'a përfutur atë, të drejtën për t'u informuar për akuzën kundër tyre dhe të drejtën për të heshtur.



Të gjithë personat e dyshuar dhe akuzuar duhet, me ligj, të pajisen me një Kartë të Drejtash. Ngjashëm me dispozitat në Direktivën e të Drejtës së Informimit, K.Pr.Penale njih të drejtën për t'u njohur me dosjen e çështjes, për të kundërshtuar arrestimin ose ndalimin dhe për të patur një proces të drejtë penal.

Sidoqoftë, një vlerësim i kujdesshëm i ligjeve dhe praktikave, nxjerr në pah praktika jo korrekte që cënojnë të drejtat e të dyshuarve dhe personave të akuzuar për të kuptuar të drejtat e tyre dhe për të marrë vendime të informuara në lidhje me çështjet e tyre. Në veçanti, përmbajtja e Kartës së të Drejtave dhe mënyra si jepet informacioni për të drejtat, nuk përputhen plotësisht me Direktivën e të Drejtës së Informimit. Duket se ligjet nuk sigurojnë akses mjaftueshëm të shpejtë dhe të duhur për t'i dhënë mundësinë personave të dyshuar dhe të pandehurve në marrjen e këtij informacioni. Për më tepër ky akses është shumë herë më i vogël për personat e tretë pozita procedurale e të cilëve është e ndryshme gjatë hetimit të kryer nga organi i Prokurorisë, pavarësisht faktit se për këta persona, të drejtat e garancitë procedurale duhet të ishin të njëjta me ato të parashikuara në Kod për të pandehurin apo personin nën hetim.

Në legjislacionin procedural penal parashikohet se personave të dyshuar dhe të akuzuar, qofshin ata të ndaluar apo në liri, *duhet t'u jepet Karta e të Drejtave me shkrim*, të cilën ata e nënshkruajnë për të treguar se e kanë kuptuar përmbajtjen e saj. Policia nuk lejohet të marrë në pyetje një person të dyshuar ose të akuzuar para se ai të jetë informuar për të drejtat e tij në Letrën e të Drejtave dhe deklaratimet e bëra nga i pandehuri para se të informohet për të drejtat e tij, nuk mund të pranohen si prova.

Në rastet e arrestimit *në flagrancë*, policia duhet të informojë personin e arrestuar për të drejtën e tij për të heshtur dhe të drejtën për t'u mbrojtur me avokat. Personi i arrestuar duhet të pajiset me Kartën e të Drejtave sa më shpejt që të jetë e mundur, para ose pas mbërritjes së tij në dhomat e paraburgimit dhe personat e ndaluar/arrestuar, kanë të drejtë të mbajnë një kopje të Kartës së të Drejtave.

Avokati i Popullit çmon se Karta e të Drejtave është e njëjtë për të gjithë personat e dyshuar dhe të akuzuar, pavarësisht nëse janë të ndaluar ose në gjendje të lirë, duke injoruar faktin se për të ndaluarit ose personat e arrestuar, ka të drejta të zbatueshme shtesë. Në veçanti, aty nuk ka informacion mbi numrin maksimal të orëve gjatë të cilave personi mund të mbahet në paraburgim para se të dalë para një autoriteti gjyqësor dhe nuk ka asnjë informacion në lidhje me të drejtën për të kundërshtuar arrestimin/ndalimin apo rishikimin e tij para një autoriteti gjyqësor.

Avokati i Popullit ka evokuar në vijimësi dhe ka arritur rezultate të kënaqshme në prezantimin e modeleve të reja në mënyrën se si Policia u komunikon palëve të drejtat e tyre procedurale. Gjithsesi vlerësojmë se gjuha e kartës mbetet formale dhe Letra e të Drejtave duhet të bëhet pjesë e procedurës së marrjes në pyetje të çdo personi, pavarësisht pozitës procedurale edhe nga organi i prokurorisë, në mënyrë që standardi i respektimit të të drejtave të shtrihet tek çdo subjekt, pavarësisht pozitës procedurale që ai ka në fazën hetimore.

Karta e të Drejtave duhet të përmbajjë një listë më të plotë të të drejtave të mbrojtjes, për t'u siguruar që personat e dyshuar dhe të akuzuar janë në gjendje të marrin vendime më të informuara në lidhje me ushtrimin e të drejtave të tyre.

Karta e të Drejtave duhet të përshtatet për kategori të ndryshme të personave, të dyshuarve dhe të akuzuar.

Në veçanti, duhet të ketë një Kartë të veçantë të të Drejtave për personat e ndaluar dhe një për të miturit, që reflekton të drejtat dhe nevojat e ndryshme që ata kanë për një komunikim sa më efektiv.

Kartat e të Drejtave duhet të shkruhen, me ndihmën e ekspertëve ligjorë dhe gjuhësorë, në gjuhë të thjeshtë, në mënyrë që ato të jenë të kuptueshme për shumicën e personave të dyshuar dhe të akuzuar.

Policië duhet t'i kërkohet të vlerësojë aftësinë e të dyshuarit/personit të akuzuar për të kuptuar përmbajtjen e saj, në mënyrë që të jepet ndihmë shtesë për t'u siguruar që ata të kuptojnë të drejtat e tyre.

Të njëjtat garanci duhet të parashikohen për të gjithë subjektet e treta në një procedim penal, duke mos e lidhur këtë detyrim ligjor vetëm me pozitën e tyre si persona nën hetim/të pandehur apo me veprime konkrete hetimore.

### E drejta e mbrojtjes

Avokati i Popullit çmon se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në epokën e globalizimit kanë marrë një rëndësi të veçantë dhe kanë një shtrirje universale. Për ligjërimin, garantimin e këtyre të drejtave në një proces penal, ka rol të veçantë mbrojtësi, pasi ai afirmohet si mbartës i këtyre të drejtave, duke garantuar një proces të drejtë ligjor.

Mbrojtja ligjore në procesin penal është specifike si për nga vetë natyra e çështjeve penale, ashtu dhe nga roli që merr avokati në këto çështje. E drejta e mbrojtjes është një nga garancitë e një procesi të rregullt ligjor, pasi siguron barazinë e palëve në proces dhe siguron zbatimin e parimit të kontradiktoritetit në gjykim. Kjo e drejtë gjen pasqyrim si në KEDNJ në Kushtetutë dhe në K.Pr.Penale. Në nenin 6/3 të KEDNJ, sanksionohet shprehimisht se:

*“Çdo i akuzuar ka të drejtë:...*

*b) t'i jepen koha dhe lehtësitë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes;*  
*c) të mbrohet vetë, ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer një mbrojtës, të mund të ndihmohet falas nga një avokat i caktuar zyrtarisht, kur e kërkojnë interesat e drejtësisë”.*

Pothuajse i njëjti formulim është pranuar edhe nga Kushtetuta në nenin 31/b, ç të saj, sipas të cilit:

*“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:...*

*b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*  
*ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme;”*

Siç del nga dispozita e mësipërme, kjo e drejtë thelbësore e të pandehurit gjatë gjithë procesit penal, jo vetëm është sanksionuar nga Kushtetuta jonë, por dhe është zgjeruar me garanci të tjera procedurale e ligjore. Në thelb të kësaj norme qëndron ideja se, çdo i akuzuar ka të drejtë të mbrojtë vetveten dhe, pavarësisht nëse ka apo jo mbrojtës, atij duhet t'i krijohen mundësitë për të realizuar mbrojtjen e tij. Kjo e drejtë me rëndësi kushtetuese, ka qenë e kufizuar dhe krejt formale në legjislacionin procedural penal të para viteve 1990, kurse sot, funksioni procedural i mbrojtjes, i shpallur e i garantuar nga Kushtetuta, është sanksionuar dhe konkretizuar në dispozitat e K.Pr.Penale, në normat që parashikojnë veprimet konkrete të subjekteve të procedimit si dhe në marrëdhëniet procedurale midis tyre, gjatë gjithë fazave të procesit penal.

Kjo garanci lind për të pandehurin, në momentin kur shfaqet funksioni i ndjekjes penale, në fazën e hetimit të çështjes penale, sepse që nga ky moment shkojnë paralelisht gjatë gjithë procesit penal, funksioni i akuzës dhe funksioni i mbrojtjes ndaj kësaj akuze. Funksioni i mbrojtjes konsiston në tërësinë e veprimeve procedurale, që synojnë të kundërshtojnë pretendimet e organit të ndjekjes penale, të rrëzojnë ose të lehtësojnë akuzën, ndaj dhe si një funksion procedural, mbrojtja përfshin si element të domosdoshëm veprimtarinë e mbrojtësit, si përfaqësues i interesave të ligjshme të të pandehurit.

Kjo e drejtë e këtij të fundit për të realizuar mbrojtjen e tij nëpërmjet ndihmës së një personi të kualifikuar në këtë fushë, jo vetëm e orienton të pandehurin mbi mjetet procedurale që duhen përdorur, por përbën edhe një garanci të rëndësishme për të qenë në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të tij në mënyrë sa më efektive, siç e kërkon edhe Konventa e Kushtetuta.

Si një parim themelor i procedimit penal, e drejta e mbrojtjes parashikohet në nenin 6 të K.Pr.Penale, sipas të cilit:

*“I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë, ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme, i sigurohet mbrojtja falas me avokat.”*

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme, është e qartë se mbrojtja, si një veprimtari procedural e vetë të pandehurit, është një e drejtë që ai e disponon e në këtë kuptim, sipas Kushtetutës dhe K.Pr.Penale, i pandehuri “mund” por

nuk detyrohet të mbrohet. Ai nuk mund të detyrohet të ushtrojë të drejtat e tij, por është detyrë e organit procedues t'a njohë të pandehurin me këto të drejta. Vetëm përjashtimisht, në kreun V të K.Pr.Penale, ku parashikohen dispozitat në lidhje me mbrojtësin e të pandehurit, në nenin 49/2 të tij thuhet se: *“ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme për të pandehurin nën moshën 18 vjeç apo me të meta fizike a psikike”*.

Në fazën e hetimeve paraprake, është prokurori që i siguron të drejtën e mbrojtjes të pandehurit nëpërmjet një mbrojtësi të caktuar kryesisht sipas nenit 49/1 dhe 49/7 e kur i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme, shpenzimet e bëra për mbrojtjen, paguhen nga shteti.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin Nr.31, dt.14.07.1998, lidhur me pretendimin e palës kërkuese, se mbrojtja e të pandehurit nga një mbrojtës i caktuar kryesisht, nuk mund të jetë efiçente për shkak se **“shteti është palë kundërshtarë” në procesin penal, thekson se:**

*“Avokati, qoftë si detyrim ligjor, qoftë për shkak të etikës profesionale, e ka për detyrë të përdorë me ndërgjegje të plotë të gjitha kompetencat që i njeh ligji aftësitë e tij profesionale për mbrojtjen e të pandehurit, njëlloj si në rastin kur zgjidhet prej vetë të pandehurit, ashtu edhe kur caktohet nga organi procedues”*.

Mbrojtësi në procesin penal ka një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm. Mbrojtësi është aktor i domosdoshëm në procesin e dhënies së drejtësisë. Personi nën hetim ose i pandehuri, nëpërmjet një mbrojtësi garanton respektimin e të drejtave që i njeh ligji dhe i jep besimin e zhvillimit të një procesi të drejtë ligjor. Avokati për realizimin sa më efiças të mbrojtjes së të pandehurit, përdor të gjithë instrumentet ligjore që parashikohen në ligj.

Nga sa më sipër, e drejta për të patur mbrojtës duhet të sigurohet edhe në mënyrë efiçente, prandaj organi procedues nuk duhet të mjaftohet vetëm me caktimin e mbrojtësit, por edhe të ndërhyjë që ai të përmbushë detyrimet e tij. Mbrojtësit duhet t'i krijohen të gjitha kushtet dhe mundësitë për realizimin e mbrojtjes. Sigurisht që detyra e mbrojtësit është të veprojë në interesin më të lartë të klientit të tij, por gjithnjë në respektim të ligjit për sa kohë që

proces i rregullt ligjor merr përparësi dhe të gjithë aktorët që marrin pjesë në zhvillimin e këtij procesi, duhet të përdorin çdo instrument ligjor që i shërben atij.

Ai garanton një parim thelbësisht të rëndësishëm që është barazia e palëve në procesin penal duke mos vendosur pjesëmarrësit në këtë proces në pozita më të disfavorshme se hetuesi apo prokurori që ka njohje të legjislacionit.

Ashtu siç e parashikon Kushtetuta, në nenin 31/ç të saj, e drejta e komunikimit privatisht midis të pandehurit e mbrojtësit të tij, është sanksionuar edhe nga K.Pr.Penale, në nenin 50/2 të tij. Për më tepër, kjo e drejtë është zgjeruar duke u parashikuar si detyrim ligjor i organit procedues: *“Njoftimi paraprakisht i mbrojtësit të të pandehurit, për të qenë i pranishëm në kryerjen e veprimeve hetimore ku kërkohet prania e të pandehurit.”*

Ky detyrim ligjor parashikohet edhe në nenet 309 dhe 310 të K.Pr.Penale, dispozita që sanksionojnë se mbrojtësi i të pandehurit ka të drejtë të jetë i pranishëm në kqyrje, në kontrollet, në sekuestrimet e kryera nga organi procedues, në bazë të dispozitave të K.Pr.Penale.

Sipas K. Pr. Penale, mbrojtësi konsiderohet palë në procesin penal dhe gëzon të gjitha të drejtat procedurale që ky legjislacion parashikon për to. Për të ndaluar çdo ndërhyrje arbitrare në ushtrimin e rregullt të detyrës nga ana e mbrojtësit dhe për të garantuar të drejtat e të pandehurit, K.Pr.Penale parashikon një sërë garancish për mbrojtësin në nenin 52 të tij.

Kjo e drejtë dhe këto kërkesa përbëjnë edhe standardin minimum të të drejtave themelore të të pandehurit që në fillimet e procesit penal, dhe sidomos përbëjnë një detyrim të padiskutueshëm për organet e procedimit të shteteve anëtare që kanë ratifikuar Konventën.

Avokati i Popullit çmon se respektimi i kësaj të drejte dhe i këtyre standardeve ndërkombëtarisht të njohura, nuk duhet të jetë një atribut i organit procedues vetëm në lidhje me personat që kanë marrë pozitën procedurale të të pandehurit apo të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale. Ky detyrim **duhet të zbatohet** për të gjithë subjektet që marrin pjesë në çdo pozitë procedurale gjatë gjithë procedimit penal, pasi nëse kjo garanci i njihet

të pandehurit që nga pikëpamja procedurale konsiderohet se është subjekti që sipas Prokurorisë dyshohet se ka kryer veprën penale, aq më tepër duhet të jetë një garanci e shtuar për persona të tjerë, pozita procedurale e të cilëve është shumë herë më pak e disfavorshme sa i takon veprës penale të kryer.

Nëse i pandehuri e gëzon këtë garanci për veprimet që kryhen në ngarkim të tij gjatë fazës hetimore, edhe të gjithë personat e tjerë qofshin ata persona që kanë dijeni në lidhje me rrethanat e hetimit, persona të cilëve iu atribuohet vepra penale, dëshmitarë apo çdo subjekt tjetër i cili është pjesëmarrës në çfarëdo lloj forme në një veprim hetimor të kryer, duhet t'í jepet kjo garanci dhe të ketë të drejtën që të shoqërohet gjatë gjithë veprimtarisë hetimore nga mbrojtësi i thirrur apo i caktuar, pavarësisht llojit të veprimit të kryer apo pozitës konkrete procedurale që mbart në një procedim të caktuar.

Avokati i Popullit çmon se në rastin konkret, Kodi i Procedurës Penale nuk ka një parashikim të plotë sa i takon pjesëmarrjes së mbrojtësit të caktuar apo të zgjedhur për të gjithë subjektet pjesëmarrës në një procedurë hetimi paraprak, për sa kohë që nenet e sipërcituara bëjnë fjalë për të pandehurin apo personin e dyshuar për kryerjen e një vepre penale sa i takon kqyrjes, kontrollit apo sekuestrimit, dhe nuk ka një parashikim specifik për të gjithë subjektet që mund të thirren nga organi procedues me një tjetër cilësi procedurale apo për veprime të tjera hetimore që mund të lindin të nevojshme të kryhen. Në këto kushte, është e nevojshme një ndërhyrje ligjore në përmirësimin e kuadrit ligjor procedural penal lidhur me garantimin e kësaj të drejte për të gjithë subjektet në mënyrë të detyrueshme, pa u kufizuar nga pozita e tyre procedurale apo lloji i veprimit hetimor që duhet të kryhet.

E drejta e mbrojtjes është një nga garancitë e një procesi të rregullt ligjor, pasi siguron barazinë e palëve në proces dhe siguron zbatimin e parimit të kontradiktoritetit në gjykim.

Kjo e drejtë parashikohet si në nenin 6/3<sup>32</sup> të KEDNJ, në nenet 28/1<sup>33</sup> dhe 31/b,ç<sup>34</sup> të Kushtetutës ashtu edhe në nenin 48<sup>35</sup> etj., të K.P.Penale. Kjo garanci i sigurohet të pandehurit dhe personit nën hetim në momentin kur fillon ndjekja penale, në fazën e hetimit, por nuk duhet të kufizohet vetëm me akuzën që i atribuohet personit që dyshohet se ka kryer veprën penale, si një minimum i nevojshëm për t'u zbatuar.

Funksioni i mbrojtjes konsiston në tërësinë e veprimeve procedurale, që synojnë të kundërshtojnë pretendimet e organit të ndjekjes penale, të rrëzojnë ose lehtësojnë akuzën. Për këtë arsye, si një funksion procedural, mbrojtja përfshin si element të domosdoshëm veprimtarinë e mbrojtësit, si përfaqësues i interesave të ligjshme të personit në një procedurë gjyqësore apo administrative. Kjo e drejtë e këtij të fundit për të realizuar garantimin e të drejtave të tij nëpërmjet ndihmës së një personi të kualifikuar në këtë fushë, jo vetëm e orienton të pandehurin apo çdo palë në procesin penal mbi mjetet procedurale që duhen përdorur, por përbën edhe një garanci të rëndësishme për të qenë në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të tij sa më efektive, siç e kërkon KEDNJ dhe Kushtetuta.

Në rastin e të pandehurit dhe jo vetëm atij, **është detyrë dhe jo e drejtë e organit procedues** të njohë të pandehurin/të gjithë subjektet me këto të drejta dhe ky standard, është i detyrueshëm dhe nuk mbetet në diskrecionin e tij personal.

---

<sup>32</sup> Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në nenin 6, pika 3/c parashikon se:

*“Çdo i akuzuar ka të drejtë që të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij...”*

<sup>33</sup> *“Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”.*

<sup>34</sup> *“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:*

*b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*

*ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;”*

<sup>35</sup> *“1. I pandehuri ka të drejtë të zgjedhë jo më shumë se dy mbrojtës.*

*2. Zgjedhja bëhet me deklaram të bërë para organit procedues ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomandë.*

*3. Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2.”*



Nëse do t'i referohemi nenit 31/ç të Kushtetutës, ku parashikohet se : “Gjatë procesit penal **kushdo ka të drejtë:** ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;” dhe ta interpretojmë në mënyrë të drejtë atë, kuptohet se rrethi i subjekteve që gëzojnë mbrojtje vetë ose **me ndihmën e një avokati, është më i gjerë.**

Pra, jo vetëm i pandehuri dhe personi nën hetim të cilët kanë një pozitë juridike të veçantë, por **edhe subjekteve të tjera** të përfshirë në një proces penal, sikurse mund të jenë, viktimat e veprës penale, personi që ka dijeni për rrethanat e çështjes, dëshmitari, kallëzuesi jo i dëmtuar (kur kallëzon një veprë penale të kryer jo ndaj tij për të cilën ka marrë dijeni), etj. duhet t'u garantohet në mënyrë të detyrueshme kjo e drejtë. Për viktimën e veprës penale mbrojtja me avokat është parashikuar në nenin 58 të K.P.Penale, ndërsa për subjektet e tjerë të përmendur më lart, **kjo e drejtë procedurale, nuk është parashikuar në dispozitat e këtij Kodi, parashikim i cili në cmuarjen e Avokatit të Popullit duhet të gjejë pasqyrim në frymën e ndryshimeve që do të aplikohen në K.Pr.Penale.**

Sipas Kodit Penal, K.Pr.Penale dhe jurisprudencës gjyqësore, ekzistojnë dy kategori kryesore personash të dyshuar për kryerjen e një veprë penale - **‘i dyshuari’** (zakonisht i referuar në legjislacionin shqiptar si “person nën hetim”), dhe **‘i pandehuri’**. K.Pr.Penale gjithashtu përdor termin “i dyshuar” në vend të termit “person nën hetim”, duke nënkuptuar jo në mënyrë korrekte që këto dy terma janë përafërsisht të njëjtë në kuptimin procedural.

**Avokati i Popullit çmon se statusi i saktë i një personi para se të njoftohet për akuzat ndaj tij është i paqartë në ligjin shqiptar dhe kjo ka sjellë cedim të të drejtave themelore të njeriut në këtë fazë shumë të rëndësishme të hetimit penal.**

Momenti i parë që një person mund të konsiderohet zyrtarisht “i dyshuar”, është kur emri i tij shënohet në regjistrin e njoftimit të veprave penale të prokurorit. Në këtë pikë, ai referohet si “personi të cilit i atribuohet vepra penale”. Ky është personi që një kallëzues ose prokuror e ka identifikuar si

autorin e mundshëm të një vepra penale. Nëse plotësohen kushtet e parashikuara, prokurori fillon hetimin penal dhe statusi i personit ndryshon në person *nën hetim*.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr.3, datë 27.09.2002 kanë trajtuar qartë konceptin e subjektit procedural të cilit “i atribuohet” vepra penale, duke përcaktuar në këtë mënyrë edhe momentin se kur subjekti merr statusin e “personit të cilit i atribuohet vepra penale”. Sipas këtij vendimi unifikues, nëse kallëzuesi e përcakton në kallëzim personin që ai mendon se ka kryer veprat penale objekt kallëzimi, **prokurori do të duhet të regjistrojë emrin e këtij personi në cilësinë e “personit të cilit i atribuohet vepra penale”, më konkretisht:**

*Terminologjia e përdorur nga Kodi i Procedurës Penale, gjatë fazave të ndryshme të procedimit penal, ndryshon nga çasti i fillimit të marrjes dijeni për veprën penale deri në përgatitjen dhe dërgimin e çështjes penale për gjykim. Cilësimi dhe emërtimi i subjekteve dhe i personave në raport me veprën penale fillojnë me termin: “personi, të cilit i atribuohet vepra penale” (neni 287 K.Pr.Penale), “person, ndaj të cilit zhvillohen hetime” (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – “b” e “d” dhe 308, etj.) dhe më pas “i pandehur” që ndeshet në shumë dispozita të Kodit të Procedurës Penale. Autori i mundshëm i veprës penale mund t’i marrë këto emërtime në faza të ndryshme të procedimit penal. Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim.*

*Termi “person, të cilit i atribuohet vepra penale”, parashikohet në nenin 287 të K.Pr.Penale dhe ligjvënësi jo pa qëllim e ka përdorur atë në kreun e dytë të titullit të gjashtë të K.Pr.Penale, ku flitet për mënyrën se si njoftohet dhe merret dijeni për një vepër penale nga ana e prokurorit dhe policisë. Cilësia e personit, të cilit i atribuohet vepra penale, fillon: a) ose kur njoftuesi i saj mendon se e di, se cili mund të jetë autori i veprës penale dhe prokurori shënon paralelisht në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, krahas veprës edhe emrin e personit kur ai njihet, ose b) mbasi është bërë regjistrimi i veprës penale, që nga çasti i mëtejshëm kur nga hetimet rezulton një emër personi të cilit, i atribuohet vepra penale. Në këto kushte, nuk ka asnjë dyshim se ky cilësim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Përcaktimi i termit: “person, të cilit i atribuohet vepra penale”, i marrë në kontekstin e*

përcaktuar nga neni 287 i K.Pr.Penale, si dhe pasur parasysh fazën procedurale në të cilën ai përdoret, do të thotë se ai nuk mund të barazohet me termin: “person, ndaj të cilit zhvillohen hetime”, e as me termin person “i pandehur”. Emri i personit, të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur ai është i njohur, por mund të ketë edhe raste kur, shpeshherë, kallëzuesi apo autoriteti referues nuk është akoma në gjendje të tregojë se kush mund të mendohet si autor i mundshëm i një vepre penale në fillimin e hetimeve. Atribuimi i faktit që përbën vepër penale ndaj një personi, nuk do të thotë se personi ka realisht lidhje me veprën penale. Lidhja e veprës penale me një emër personi, mund të dalë vetëm me kryerjen e hetimeve dhe të dhënave të mbledhura, prej të cilave do të rezultojë një lidhje mes veprës penale që procedohet dhe përgjegjësisë së prezumuar të një personi të caktuar. Vetëm pas daljes së kësaj lidhje dhe në çastin kur identifikohet emri i personit (neni 293 K.Pr.Penale) vepra penale mund t’i atribuohet një personi të caktuar. Pra, krahas lajmit për kryerjen e një vepre penale që merret me kallëzimin apo referimin, në regjistër shënohet edhe emri i personit, të cilit “i atribuohet” vepra penale.

Me avancimin e fazës së hetimeve paraprake, kuptohet se ndryshon dhe gjendja procedurale penale e subjektit të veprës penale, i cili nga cilësia e personit që i atribuohet vepra penale, kalon në cilësinë e “personit ndaj të cilit, zhvillohen hetime”, fakt ky që nënkupton se gjatë hetimeve paraprake, nga momenti fillestar i çeljes së procedimit penal kanë filluar të mbledhen të dhëna, të cilat janë në gjendje të mbështesin akuzën që do të mund të ngrihet në fazën e gjyqimit. Termi: personi ndaj të cilit zhvillohen hetime është frymëzuar nga sistemet procedurale penale që pranojnë rregullin, sipas të cilit, cilësimi si i pandehur bëhet në përfundim të hetimeve, vetëm atëherë kur ka elemente për të vendosur që çështja penale mund t’i kalojë gjykatës për gjykim. Edhe ky cilësim i dytë që merr autori i mundshëm i veprës penale gjatë hetimeve paraprake nuk mund të barazohet me termin “i pandehur”. Personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet është një figurë procedurale e ndërmjetme që qëndron midis asaj që Kodi Procedurës Penale quan “person, të cilit i atribuohet vepra penale” dhe “të pandehurit”. Vetëm drejt çasteve të përfundimit të fazës së hetimeve paraprake, Kodi i Procedurës Penale përdor termin “i pandehur”. I pandehuri është personi që i atribuohet formalisht vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës. Ky status procedural është më i avancuar dhe relativisht më i qëndrueshëm, i cili ruhet i

*pandryshuar, në çdo gjendje dhe shkallë të procesit penal, derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose fajësisë (neni 34/2 i K.Pr.Penale).*

*Sa më sipër, arrihet në përfundimin se figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale që nga çasti i njoftimit të saj në prokurori e deri në momentin e përfundimit të hetimeve paraprake (neni 327 i K.Pr.Penale), evoluon gradualisht nga “personi, të cilit i atribuohet vepra penale” në “personin ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe së fundmi në atë të “të pandehurit”, pavarësisht nëse çështja pushohet (neni 328) apo dërgohet për gjykim (neni 331). Si rregull, statusi i të pandehurit merret në përfundim të hetimeve paraprake përpara se të depozitohet fashikulli i gjykimit, por ky status mund të merret edhe me përpara. Kjo është në çmimin e prokurorit, i cili mund të bëjë njoftimin e akuzës në çdo fazë të hetimeve, deri në përfundimin e tyre, pasi ai të ketë mbledhur të dhënat e mjaftueshme (neni 34/1 i K.Pr.Penale).*

Ndërkohë në vendimin unifikues nr.2, datë 20.06.2013 Kolegjet e Bashkuara shprehen si më poshtë:

*Procedimi penal merr shkas nga njoftimi që merr prokurori kryesisht apo nga policia gjyqësore, por edhe nga kallëzimi i shtetasve apo personave juridikë për ngjarjen e një veprë penale. Prokurori regjistron procedimin penal fillimisht për veprën që ai ka marrë njoftim se është kryer e, sipas rastit, edhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Është pikërisht ky momenti që prokurori ka mundësi të verifikojë nëse ndodhemi para rasteve të parashikuara prej nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, pra nëse ndodhemi përpara rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe që legjitimojnë marrjen e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal. Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë, mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi. Si subjekte që marrin pjesë në këtë fazë, përveç prokurorit dhe policisë gjyqësore, janë edhe kallëzuesi, si njoftues i veprës penale, e në varësi të rast.*

Gjithashtu, Vendimi nr.7, datë 16.01.2012 i Gjykatës Kushtetuese, shprehet se nëse kallëzuesi në kallëzimin e tij mendon se një person i caktuar është autor i ndonjë veprë penale, ky person të cilit kallëzuesi i atribuon autorësinë e veprës penale, **do të duhet të regjistrohet nga organi procedues në pozitën e personit të cilit i atribuohet vepra penale.**

Avokati i Popullit çmon se organi procedues, në më të shumtën e rasteve, njoftimin e akuzës e lidh vetëm me fazën përfundimtare të hetimeve paraprake, duke bërë që personi i proceduar deri në përfundim të hetimeve, të mos gëzojë të njëjtat të drejta procedurale si ato të të pandehurit apo personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale. Për sa kohë që dispozitat përkatëse të K.Pr.Penale nuk kanë një parashikim specifik lidhur me normimin se për sa kohë e çfarë veprimeve konkrete duhet të kryhen nga organi i Prokurorisë nga momenti i regjistrimit të veprës penale dhe deri kur subjekti i dyshuar të marrë pozitën e të pandehurit, në praktikë ndodh shpesh që shumica e veprimeve hetimore në ngarkim të këtij personi, kryhen pa pjesëmarrjen e mbrojtësit të tij, në kushtet kur ai ende nuk është marrë i pandehur.

Kjo praktikë në kushtet kur çënon të drejtat dhe standardet e sipërcituara lidhur me respektimin e të drejtës së mbrojtjes, duhet të gjejë një rregullim ligjor specifik si përsa i përket pranisë së detyrueshme të mbrojtësit gjatë të gjithë veprimeve procedurale të kryera, pavarësisht pozitës që ka personi gjatë hetimit, ashtu edhe lidhur me faktin që kjo pozitë duhet të jepet gjatë hetimit dhe jo në fund të tij, siç edhe ndodh në praktikë, fakt i cili mund të përbëjë shkelje të të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Ky fakt duhet vlerësuar e mbajtur parasysh për të bërë ndryshimet e nevojshme të K.P.Penale duke e përafuar atë edhe me legjislacionin e BE, standardet më të larta të të drejtave të njeriut të parashikuara në aktet ndërkombëtare dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Konventat ndërkombëtare parashikojnë standardet minimale të të drejtave të njeriut të cilat përbëjnë detyrim për shtetet palë, por, kjo nuk pengon asnjë shtet palë që të ngrejë nivelin e standardeve mbi atë minimal të parashikuar në Konventa.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut ka gjetur pasqyrim dhe përshtatje të plotë në dispozitat kushtetuese për të pandehurin dhe udhëheq

normat e së drejtës, për sa i përket parimit universal të mbrojtjes së të drejtave të tij. Në nenin 6 të saj, kjo Konventë sanksionon “të drejtën për një proces të rregullt ligjor” me dispozitën:

*“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për konfliktet dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij”.*

Pra, vihet re se e drejta për një proces të rregullt ligjor është afirmuar edhe nga Kushtetuta, në nenin 42/2 të saj. E drejta për një proces të rregullt ligjor parashikohet në nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, me këtë formulim:

*“Çdokush ka të drejtë të barabartë të dëgjohet, drejtësisht e publikisht, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në mënyrë që të merret një vendim mbi të drejtat dhe detyrimet e tij apo dhe mbi akuzat penale të ngritura ndaj tij”.*

KEDNj, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionojnë këtë të drejtë dhe i japin asaj një kuptim mjaft të gjerë. Me termin “**proces i rregullt ligjor**”, do të nënkuptojmë faktin se **çdo person** gëzon të drejtën e një procesi të rregullt ligjor dhe nëse të drejtat e tij të parashikuara në Konventë dhe në Kushtetutë janë cenuar, dhe **ai është subjekt në një proces**, atëherë i lind e drejta për të kërkuar një proces të rregullt ligjor.

Në këto kushte, mosrespektimi i nenit 6 (parimi i mbrojtjes) passjell në mënyrë të detyrueshme edhe shkeljen e procesit të rregullt ligjor, parim i cili mbrohet jo vetëm në të drejtën procedurale penale, por edhe atë administrative e ligje të veçanta.

Këtë konkluzion e mbështesim edhe duke i referuar nenit 35<sup>36</sup> të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 109/3<sup>37</sup> të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Sipas dispozitave të këtyre akteve normative, e drejta e mbrojtjes me avokat i garantohet çdo personi që është subjekt i një procedimi administrativ, **si dhe i personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit edhe për probleme administrative e jo vetëm për ato penale.**

Në këto kushte, rekomandimi i bërë nga Avokati i Popullit se garantimi i mbrojtjes duhet të parashikohet për një kategori më të gjerë personash/subjektsh procedurale penale, do të jetë një garanci më shumë për respektimin e të drejtave dhe interesave të tyre ligjore nga organi procedues dhe do të rrisë besimin e publikut ndaj këtyre strukturave shtetërore.

Ndërkohë në rastin objekt shqyrtimi, kërkesat për marrjen e sekuestrove dhe vleftësimi i tyre nga gjykata është bërë ndërsa Z. Qyno ishte brenda godinës së SPAK dhe pa mundësi lëvizjeje.

Në kushtet kur z. Qyno ishte i izoluar në ambientet e SPAK, ai nuk është njoftuar për seancat e zhvilluara më dt.13.12.2023, në orët 14:20, 15:15 dhe 15:55 në GJKKO në mënyrë që të merrte pjesë në këto seanca. **Është e rëndësishme të evidentojmë, se prokurori ka qenë në dijeni të faktit se personin ndaj të cilit po kërkonte këto masa e kishte të izoluar në ambientet e veta të organit të prokurorisë dhe përsëri nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për t’i dhënë mundësinë këtij shtetasi të jetë prezent në secilën prej seancave gjyqësore të zhvilluara.**

Mundësia e marrjes së një vendimi pa praninë e palës s’ mund e s’ duhet të kthehet në rregull. Për këtë arsye vlerësojme se ka vend për të përmirësuar qasjen duke patur vëmendje të shtuar në lidhje me të drejtat e palëve në procesin penal edhe referuar këtij momenti procedural.

<sup>36</sup> Në nenin 35 “Përfaqësimi i palës” parashikohet se:

“1. Palë mund t’i kryejë të gjitha veprimet procedurale personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit, në përputhje me parashikimet e këtij Kodi...”

<sup>37</sup> 3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

### E drejta e mosinkriminimit të vetvetes dhe e drejta për të heshtur

Megjithëse këto dy të drejta nuk përmenden shprehimisht në tekstin e Konventës, nëpërmjet jurisprudencës së saj, Gjykata Europiane i ka cilësuar ato si standarde ndërkombëtare që ndodhen në themel të nocionit të një procedure të paanshme, sipas nenit 6 të Konventës.

E drejta e mosinkriminimit të vetvetes, veçanërisht presupozon që prokuroria për vërtetimin e akuzës ndaj të pandehurit, të mos mbështetet në dëshmi të siguruara nëpërmjet metodave të kërcënimit ose të shtypjes, në kundërshtim me vullnetin e të pandehurit. Kjo e drejtë ka të bëjë gjithashtu me respektimin e vullnetit të një personi të akuzuar për të heshtur.

Kushtetuta në nenin 32/1 të saj parashikon se: *“Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.”*

Garancitë që ofron shprehimisht kjo dispozitë kushtetuese janë:

Të akuzuarit nuk mund t'i vijë asnjë pasojë nga fakti që ai nuk e pohon fajësinë e tij, sepse ky fakt nuk mund të përdoret në dhënien e vendimit nga gjykata dhe as të kombinohet me provat e marra prej saj ;

Asnjë person nuk mund të akuzohet për dëshmi të rreme apo refuzim për të dëshmuar, nëse nuk ka treguar fajësinë e një të afërmi të tij. Çdo i akuzuar ka të drejtë të heqë dorë nga e drejta për të heshtur, por pohimet e tij mbi veprën penale të kryer, apo shpjegimet e tij duhet të vlerësohen në tërësi me provat e tjera (neni 152 i K.Pr.Penale).

Nga sa më sipër, rezulton se një person nuk mund të deklarohet fajtor e të dënohet vetëm mbi bazën e pohimit të vetë atij. Heshtja e të pandehurit nuk mund të përdoret si provë e vetme apo kryesore, por mund të përdoret si provë e zakonshme në tërësinë e provave të tjera që formojnë bindjen e brendshme të gjyqtarit.

Në bazë të Kodit të Procedurës Penale, në përshtatje me Konventën dhe Kushtetutën, këto të drejta i pandehuri i gëzon që nga momenti kur ai merr



cilësinë si i tillë, dhe derisa vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë, qoftë ky vendim pushimi, pafajësie apo dënimi (neni 38/3). Pra, edhe gjatë fazës së gjykimit të pandehurit i njihet kjo e drejtë dhe, në bazë të nenit 353 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të të pandehurit, kur nuk është paraqitur apo është deklaruar në mungesë, nëse prania e tij është e domosdoshme për marrjen e një prove, por jo për pyetjen e tij.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, thëniet e të pandehurit përbëjnë një ndër llojet e provave në procesin penal, por neni 166 i këtij Kodi thekson se i pandehuri pyetet vetëm kur:

- 1) e kërkon një gjë të tillë,
- 2) jep pëlqim kur kërkohet pyetja e tij.

Në çdo rast, para se të fillojë pyetja e tyre, gjykata e njeh të pandehurin me të drejtën për të mos u përgjigjur (të drejtën e heshtjes, neni 167/4).

Referuar përmbajtjes së ankesës së ushtruar nga gazetari Elton Qyno, Avokati i Popullit çmon se mbajtja e këtij shtetasi për një periudhë prej 7 orësh në ambientet e Prokurorisë së Posaçme duke i kërkuar të japë deklarime lidhur me burimin e informacionit të marrë e të publikuar, pa praninë e një mbrojtësi duke mos respektuar të drejtën e heshtjes sipas dispozitave të sipërcituara, është shkelje e procesit të rregullt ligjor i cili në rastin konkret, nuk duhet të kufizohet vetëm për të pandehurin në një procedim penal apo gjykim të zhvilluar, por duhet të respektohet si një garanci kushtetuese edhe për të gjithë subjektet e tjera në këtë procedim.

### ***Sekuestrimi i materialeve kompjuterike***

Lidhur me qëllimin për të cilin janë kryer këto veprime procedurale në ngarkim të gazetarit Elton Qyno, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, Avokati i Popullit vlerëson se nga rrethanat e çështjes duket në mënyrë të qartë se vendimi i gjykatës nuk synon sekuestrimin e të dhënave kompjuterike si një mënyrë e vetme dhe e domosdoshme për të siguruar provën, por ai synon të realizojë zbulimin e burimit të informacionit të publikuar nga gazetari, pikërisht

personin/personat nga të cilët e ka siguruar ai këtë informacion. Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata ka legjitimuar praktikisht sekuestrimin e çdo mjeti elektronik (kompjuteri, usb, cd, dvd etj), por pa përcaktuar asgjë të detajuar e asnjë modalitet, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe praktikën gjyqësore të konsoliduar lidhur me këtë problematikë të ndjeshme.

Në dispozitat përkatëse procedurale penale, nuk ka një parashikim të detajuar lidhur me mënyrën se si duhet të bëhet sekuestrimi i materialeve kompjuterike, në kushtet kur teknologjia tashmë është bërë pjesë integrale e jetës së çdo shtetasi dhe pasqyron detaje thelbësisht personale të secilit prej nesh. Sekuestrimi i aparateve telefonike të ankuesit e familjarëve të tij dhe kqyrja përkatëse e përmbajtjes së tyre, nuk ka një pasqyrim të detajuar në vendimet përkatëse gjyqësore, pasqyrim i cili do të përbënte edhe vendosjen e një standardi të nevojshëm mes respektimit të një procesi të rregullt ligjor dhe të drejtës për një jetë private dhe personale.

Një aparat telefonik nuk ka të kufizuara në kohë materialet që disponon, pasi në përmbajtjen e tij mund të ketë dhe gjenden jo vetëm të dhëna që lidhen me një periudhë të caktuar kohore, por edhe të dhëna të tjera të cilat nuk janë të kufizuara me momentin kur është bërë i përdorshëm ky aparat telefonik.

Avokati i Popullit çmon se sekuestrimi dhe kqyrja e tij duhet të bëhet me një vendim të detajuar, pasi tashmë “sekuestrimi i telefonit personal të një shtetasi” është në një farë mënyre sekuestrimi i “jetës digjitale” të tij. Ky sekuestrim dhe kqyrja përkatëse duhet të jetë shumë mirë i rregulluar në dispozitat përkatëse procedurale lidhur me mënyrën se si duhet të realizohet kqyrja, të drejtën e personit të cilit i është sekuestruar aparati telefonik apo mbrojtësit të tij të jetë prezent gjatë kqyrjes, kufijtë brenda të cilave duhet të realizohet kjo kqyrje për sa kohë që ajo ka të bëjë me një veprimtari të caktuar të personit dhe jo për të marrë dijeni për të gjithë “jetën” e tij. Në kushtet kur në vendimet përkatëse të sekuestros nuk kishte të dhëna të detajuara lidhur me procedurën që duhej ndjekur për të realizuar kqyrjen dhe kufijtë brenda të cilave do të kryhej ky veprim procedural, Avokati i Popullit çmon se vendimmarrja më së pakti, nuk ka qenë proporcionale.

Po ashtu, kontrolli i automjetit dhe i “Bar-Kafe CLAS”, si dhe sekuestrimi i telefonave të ankuesit e i disa sendeve personale të tij dhe të fëmijëve të tij të mitur, është bërë në mënyrë të kundërligjshme sepse nuk ishte në kushtet e parashikuara në dispozitat e K.Pr.Penale. Ky veprim nuk ishte parashikuar në vendimet e kontrollit dhe sekuestrimit të sendeve të tij të nxjerra nga GJKKO, e në këto kushte është kryer në kundërshtim me to. Për më tepër, këtë shkelje e ka konstatuar edhe GJKKO e Shkallës së Parë në vendimin e datës 27.12.2023.

Nga oficerët e policisë gjyqësore të SPAK që kanë kryer veprimet e kontrollit të automjetit dhe sekuestrimit të sendeve personale të ankuesit, si dhe prokurorët e kësaj strukture, nuk janë zbatuar detyrimet e parashikuara në nenet 298/4 dhe 301 të K.P.Penale **për të bërë me vendim të motivuar vleftësimin e kontrollit dhe të sekuestros**. Për rrjedhojë nuk rezulton që të jetë bërë njoftimi i ankuesit e dhënë atij kopje e këtij vendimi brenda afatit ligjor<sup>38</sup>.

Kontrolli i automjetit të ankuesit nga oficerët e policisë gjyqësore pa praninë e mbrojtësit dhe/ose personit të besuar, dhe fillimi i kontrollit të banesës së tij, pa praninë e mbrojtësit dhe/ose personit të besuar, është bërë në kundërshtim me nenin 205, pikat 1 e 2 të K.Pr.Penale<sup>39</sup>. Avokati Arben

<sup>38</sup> Neni 301 i KPP, “Vleftësimi i sekuestros”

1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja.

2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë, të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t’i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros.

<sup>39</sup> Neni 205 i KPP, “Kontrolli i vendeve”

1. Të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe atij që ka në dispozicion vendin u dorëzohet kopja e vendimit të kontrollit, duke e njohur me të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar, i cili ndodhet aty dhe është i përshtatshëm, sipas nenit 108, të këtij Kodi, ose mbrojtësit të tij.

2. Kur i pandehuri kërkon praninë e mbrojtësit gjatë kryerjes së kontrollit, organi procedues shtyn kryerjen e kontrollit deri në mbërritjen e mbrojtësit, por jo më shumë se 2 orë nga momenti që mbrojtësi ka marrë dijeni për kontrollin. Gjatë kësaj kohe, organi procedues mund të kufizojë lëvizjen e personit të interesuar dhe personave të tjerë që ndodhen në vendin që do të kontrollohet.

3. Shtyrja e kontrollit, sipas paragrafit 2, të këtij neni, zgjat afatin përkatës të parashikuar në paragrafin 4, të nenit 202/a, të këtij Kodi.

4. Organi procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm, kur çmon se këta mund të fshehin provën materiale ose sendet që i përkasin veprës penale. Ai mund të urdhërojë që të pranishmit të mos largohen para se të mbarojë kontrolli dhe të kthehen forcërisht ata që largohen.

5. Kur nuk njihet ose nuk gjendet pronari ose poseduesi i sendit, organi procedues kryen kontrollin në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të caktuar kryesisht.

Llangozi, vetëm pas debateve me oficerët e policisë gjyqësore, është pranuar të jetë i pranishëm gjatë kontrollit deri në përfundimin e tij.

Avokati i Popullit vlerëson se sidomos lidhur me sekuestrimin e materialeve kompjuterike, duhet të kryhen ndryshime ligjore të cilat jo vetëm të lehtësojnë kryerjen e hetimeve nga organi procedues, por të bëjnë të mundur edhe respektimin e të gjitha standardeve ligjore kombëtare e ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut lidhur me respektimin e jetës private dhe familjare të shtetasve të cilëve iu sekuestrohen këto sende dhe materiale.

Po ashtu, shumë i rëndësishëm është edhe fakti se sekuestrimi i mjeteve e pajisjeve elektronike duhet të jetë proporcional dhe të trajtohet brenda një cilësimi të caktuar të veprimtarisë hetimore. Avokati i Popullit gjen rastin të bëjë prezent shqetësime të vazhdueshme të organizatave ndërkombëtare në mbrojtje të drejtave të njeriut e të medias së lirë, sipas të cilave sekuestrimi i mjeteve të punës së gazetarëve të mos jetë qëllim për zbulimin e burimeve gazetareske apo edhe për shuarjen e opinionit kritik në vend<sup>40</sup>.

Për sa më sipër, ndonëse një mjet publikisht i konsideruar i vlefshëm në hetimin dhe provimin e rasteve të vështira të korrupsionit apo sigurisë kombëtare, **sekuestrimi i sendeve të komunikimit personal duhet të bëhet duke patur në vëmendje detyrimet e parashikuara nga neni 8 i KEDNJ.** Ato duhet të përdoren si mjeti i fundit për arritjen e qëllimit të lavdërueshëm të ndjekjes penale në përputhje me ligjin dhe të garantojnë në thelb të drejtën për privatësi dhe të drejtën e gazetarëve për të ruajtur burimet e tyre të informacionit.

Avokati i Popullit vlerëson se pavarësisht kujdesit që mund të kenë strukturat e prokurorisë apo sistemit gjyqësor, kjo çështje ka nevojë imediate të rregullohet në ligj, për të vendosur një balancë të drejtë midis nevojës, qëllimit të hetimit dhe garantimit të jetës private.

### **Sigurimi i ndihmës juridike efektive gjatë marrjes në pyetje/hetim**

<sup>40</sup> <https://rm.coe.int/annual-report-2024-platform-for-safety-of-journalists>. Annual assessment of press freedom in Europe by the partner organisations of the Safety of Journalists Platform 2024.

Prania e një avokati gjatë marrjes në pyetje nga policia është «i detyrueshëm» dhe autoriteti procedues (si policia) duhet t'i sigurojë menjëherë një avokat të caktuar nga shteti personit të arrestuar /ndaluar, nëse ai nuk ka zgjedhur ende një avokat. Avokatët e mbrojtjes lejohen të marrin një rol aktiv gjatë marrjes në pyetje të policisë, ndër të tjera, duke këshilluar klientët e tyre se si t'u përgjigjen pyetjeve, duke ndërhyrë gjatë marrjes në pyetje me qëllim që të japin këshilla (dhe duke kërkuar pushime të shkurtra për të biseduar me klientin e tyre), duke siguruar që përgjigjet e klientit të tyre të regjistrohen si duhet, dhe duke kontrolluar saktësinë e të dhënave të marrjes në pyetje. Ligji shqiptar nuk përmban asnjë kufizim për rolin e avokatëve gjatë marrjes në pyetje. K.Pr.Penale përmban masa mbrojtëse shtesë që synojnë të sigurojnë që një person i dyshuar ose i akuzuar të ketë akses në ndihmë juridike gjatë gjithë hetimit penal dhe pyetjet nga prokurori duhet të bëhen në prani të një avokati. Në përputhje me nenet 3 (2) (b) dhe 3 (3) të Direktivës së të Drejtës së Mbrojtjes me Avokat, të gjitha veprimet hetimore të urdhëruara nga prokurori duhet të zhvillohen në prani të një avokati, përfshirë procedurën e njohjes, ballafaqimet dhe rindërtimet e vendit të ngjarjes. Nëse avokati i të pandehurit nuk paraqitet pa ndonjë arsye të përligjur, atëherë mund të kryhen veprime hetimore në mungesë të avokatit mbrojtës, i cili do të gjobet për mosparaqitje. I pandehuri gjithashtu ka të drejtë të kërkojë praninë e avokatit të tij mbrojtës gjatë kontrollit në banesë. Në raste të tilla, autoriteti procedues duhet të shtyjë kontrollin e banesës për një periudhë maksimale prej dy orësh nga momenti kur avokati mbrojtës informohet për kontrollin. Praktika ka treguar se këto dispozita ligjore nuk janë respektuar në disa raste dhe është proceduar me kryerjen e kontrollit në shtëpi pa iu dhënë mundësi personit të sigurojë praninë e një mbrojtësi, ashtu siç edhe ka ndodhur në rastin e ankuesit Elton Qyno. Në praktikë, ka pengesa të konsiderueshme që dëmtojnë ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave dhe është shqetësim serioz që të dyshuarit dhe personat e akuzuar më vulnerabël, përballen me disavantazhe serioze në lidhje me ndihmën juridike.

Avokati i Popullit vlerëson se ndihma juridike efektive gjatë marrjes në pyetje, nuk duhet të jetë një detyrim ligjor vetëm për personat nën hetim apo të pandehurit, por ajo duhet të gjejë zbatim si një standard i respektimit të të drejtave të njeriut edhe për të gjithë personat e tretë, pavarësisht pozitës procedurale që ata kanë në një procedim të nisur nga organi i Prokurorisë.

Nëse për të pandehurin dhe personin nën hetim kjo e drejtë është parashikuar në legjislacionin procedural penal, **lidhur me personat e tretë parashikimi ligjor nuk është në përputhje me Direktivën e së Drejtës së Mbrojtjes me Avokat**, pasi mbrojtja efektive nuk u sigurohet këtyre shtetasve gjatë të gjithë veprimeve procedurale që kryhen, si marrja në pyetje, kontrolli, sekuestrimi etj.

Në këto kushte, lind e nevojshme kryerja e ndryshimeve ligjore në mënyrë që mbrojtja efektive me avokat të mos kufizohet thjesht me një pozitë të caktuar procedurale të tillë si qenia person nën hetim apo i pandehur, por ajo të shtrihet si një garanci kushtetuese e konventore për të gjithë subjektet gjatë të gjithë veprimtarisë hetimore që mund të kryhet nga organi i Prokurorisë.

### **Cilësimi i pozitës procedurale të një shtetasi**

Fryma e Avokatit të Popullit është që shtyrja në kohë e cilësimit të pozitës procedurale të një shtetasi mund të përbëjë cenim të të drejtave të tij procedurale. Për këtë, ose një pjesë e veprimeve procedurale duhet të kryhen vetëm pas cilësimit të personave dhe regjistrimit të të pandehurve, ose duhet të garantohet për të tërë e drejta për t'u mbrojtur me avokat në çdo fazë të përballjes me organet e prokurorisë apo hetuesisë.

Ne nuk mund t'u japim më pak mbrojtje qytetarëve të thjeshtë që nuk kanë kryer veprë penale sesa ata që hetohen apo akuzohen me dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale. Tek e fundit, garancitë procedurale janë parashikuar si rezultat i verifikimit se ka mundësi potenciale abuzimi me individët nga organi i ushtrimit të akuzës.

Sjellim në vëmendje se, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre, duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave dhe forcimin e shtetit ligjor.

Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i

barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës<sup>41</sup>. Të tërë duhet të qëndrojmë fort *versus* veprimeve të *Securitization* të shtetit, në çdo element të tij dhe nga secili prej pushteteve.

Së fundmi, Raporti i Organizatës Reporterë pa Kufij për vitin 2024, e vlerëson gjendjen e lirisë së medias mbi një metodë të hollësishtme referuar statusit të ligjeve që prekin lirinë e medias, duke e konsideruar gjendjen në Shqipëri si “të vështirë”. Gjendja e Shqipërisë vlerësohet ndjeshëm ndër të tjera më keq se në vitin 2022 për shkak të treguesit të gjendjes së sigurisë së gazetarëve.

K.Pr.Penale në nenin 159<sup>42</sup> të tij, parashikon garanci të posaçme për ruajtjen e sekretit profesional. Përveç disa subjekteve të tjerë, këtë garanci lidhur me ruajtjen e burimit të informacionit e gëzojnë edhe gazetarët profesionistë. Sipas kësaj dispozite, gazetarët profesionistë nuk mund të detyrohen të dëshmojnë për sa dinë për shkak të profesionit, lidhur me emrat e personave nga të cilët ata kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, pra burimet e informacionit. Sipas pikës 3 të këtij neni, ata përjashtohen nga kjo garanci vetëm në rastet **kur të dhënat janë të domosdoshme** për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë **vetëm** nëpërmjet identifikimit të burimit të tyre. Dhe në këtë rast, gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij.

---

<sup>41</sup> Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.02.2007

<sup>42</sup> Në nenin 159 “Ruajtja e sekretit profesional” parashikohet se:

“1. Nuk mund të detyrohen të dëshmojnë për sa dinë për shkak të profesionit, me përjashtim të rasteve kur kanë detyrimin që t’ua referojnë autoriteteve proceduese:

- a) përfaqësuesit e besimeve fetare, statutet e të cilëve nuk janë në kundërshtim me rendin juridik shqiptar;
- b) avokatët, përfaqësuesit ligjorë dhe noterët;
- c) mjekët, kirurgët, farmacistët, obstetrët dhe kushdo që ushtron një profesion shëndetësor;
- ç) ata që ushtrojnë profesione të tjera, të cilëve ligji u njeh të drejtën të mos dëshmojnë për ato që lidhen me sekretin profesional.

2. Gjykata, kur ka arsye të dyshojë se pretendimi i bërë nga këta persona për t’iu shmangur dëshmisë nuk ka baza, urdhëron verifikimet e nevojshme. Kur ai rezulton pa baza, gjykata urdhëron që dëshmitari të deponojë.

3. Dispozitat e parashikuara nga paragrafi 1 dhe 2 zbatohen edhe për gazetarët profesionistë lidhur me emrat e personave nga të cilët ata kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Por, kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij.”

Administrimi i të dhënave elektronike nga kompjuterat e aparatet telefonikë krijon lehtësitë e duhura për të arritur te burimi i informacionit, megjithëse nuk gjendemi në kushtet e kërkuara nga dispozita e cituar më sipër.

Pra, ligji është shumë i qartë lidhur me këtë çështje që do të thotë se, ***mbrojtja e burimeve të gazetarit mund të kufizohet vetëm në rast se të dhënat janë të domosdoshme***, e jo thjesht ***të nevojshme*** për të provuar veprën penale. Në rastin e gazetarëve profesionistë, në ndryshim nga qytetarët e zakonshëm, mjetet në dorën e organit të hetimit janë të kufizuara, me qëllim ruajtjen e interesave konkurruese. Interesi i mbrojtjes së burimeve të gazetarit është i lidhur ngushtë me lirinë e shprehjes, të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës dhe nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas interpretimeve të Konventës të bëra nëpërmjet jurisprudencës së GJEDNJ, liria e shprehjes së gazetarëve ka një mbrojtje shtesë për shkak të interesit publik që ata përfaqësojnë. Në këtë kuadër, për të ruajtur marrëdhëniet e besimit mes gazetarit (në cilësinë e rojtarit publik) dhe burimit të informacionit, identiteti i këtij të fundit nuk duhet bërë i ditur, me qëllim që burimet të inkurajohen të bashkëpunojnë me gazetarët në interes të informimit të publikut mbi çështje të rëndësishme.

Në çështjen *Goodvin kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1996) GJEDNJ shprehet se:

*«Burimet e gazetarëve gjithashtu mbrohen nga neni 10 i Konventës. Gjykata shpjegoi se mbrojtja e burimeve të gazetarëve është një nga kushtet bazë të lirisë së shtypit. Pa një mbrojtje të tillë, burimeve mund t'u priset mendja të mos ndihmojnë shtypin për ta informuar atë mbi çështje të interesit publik. Si rezultat, roli mbikëqyrës publik jetik i shtypit mund të priset dhe aftësia e shtypit për të siguruar informata të sakta e të besueshme mund të afektohet negativisht».*

Në rastin në shqyrtim Avokati i Popullit çmon se ekzistojnë të gjitha mundësitë që, të dhënat që kërkohen nga Prokuroria e Posaçme mund të nxirren nga hetimi në burime të tjerë, siç janë vetë prokurorët e hetimit nr. 75/2022, oficerët e policisë gjyqësore që janë angazhuar në këtë dosje, etj., **përmes pyetjes së tyre, gjurmimit të komunikimeve elektronike të tyre,**



**gjurmimit të lëvizjeve të tyre, përgjimeve e metodave të tjera speciale të hetimit, etj.**

Ne çmojmë se SPAK gjendet para nevojës për të hetuar veprat penale të procedimit nr. 75/2022 dhe për të hetuar mbi nxjerrjen e sekretit hetimor, në kuadër të procedimit nr. 245/2023, **por nuk ndodhemi përpara rastit të domosdoshmërisë** (sipas nenit 159, pika 3 e K.Pr.Penale), sepse për hetimin e këtij procedimi ka shumë mundësi të tjera teknike e juridike. Ndërkohë organi procedues nuk ka asnjë pengesë për të kryer veprimet hetimore pa cenuar garancitë që i jep KEDNJ burimeve të informimit të gazetarit. Prokuroria e Posaçme arritjen e qëllimit të hetimit të këtij procedimi mund e duhet t'a realizonte me mjete ligjore, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë, praktikat më të mira dhe standardet më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Një nga argumentet për të arritur në këtë konkluzion është edhe fakti se procedimi nr. 245/2023 ka nisur në datën 12.12.2023 dhe kontrolli e sekuestrimi i pajisjeve dhe të dhënave elektronike të ankuesit, është kryer në datën 13.12.2023, pra vetëm një ditë më pas.

Sikurse rezulton në mënyrë të qartë, organi i akuzës nuk ka patur as kohën, as mundësitë, as vullnetin dhe nuk ka konsideruar mjete të tjera për të kërkuar e zbuluar shkelësin/shkelësit e ligjit, por është drejtuar drejtpërdrejtë dhe ekskluzivisht te gazetari, pa ezauruar paraprakisht mundësitë e tjera të hetimit.

Sipas vlerësimit tonë, edhe GJKKO e të dy shkallëve (ajo e shkallës së parë dhe e apelit) **nuk kanë bërë një vlerësim të kriterëve për këtë ndërhyrje në lirinë e shprehjes së ankuesit.**

Prokuroria i ka orientuar hetimet vetëm në identifikimin e burimit të informacionit dhe jo në pyetjen e personave të identifikuar si subjekte të mundshme të veprës penale të parashikuar në nenin 295/a të Kodit Penal, paragrafi 3, të cilët janë vetë prokurorët dhe OPGJ-të e hetimit të procedimit penal nr. 75/2022.

Në këtë situatë, Gjykatat duhet të orientonin Prokurorinë për mundësitë e kryerjes së veprimeve hetimore që nuk ishin ezauruar ende, dhe të mos cënonin garancitë kushtetuese dhe konventore të mbrojtjes së burimeve të gazetarit. Fakti që është urdhëruar sekuestrimi i pajisjeve elektronike është edhe më i rëndë se vetë urdhëri për të treguar burimin. GJEDNJ, në çështjen *Sedletska kundër Ukrainës* (42634/18, 1 Prill 2021) shprehet se:

*«63. Në një seri çështjesh në lidhje me kontrollet në shtëpitë e gazetarëve dhe vendet e tyre të punës dhe sekuestrimin e materialit gazetaresk, Gjykata pranoi që masa të tilla, edhe nëse nuk ishin produktive në vetvete, ato përbënin një lloj ndërhyrje më drastike sesa një urdhër që thjesht synon zbulimin e identitetin të burimit, meqenëse masa të tilla i japin mundësi autoriteteve përkatës të kenë akses në një gamë të gjerë të materialit të përdorur nga gazetarët në kryerjen e funksioneve të tyre profesionale (shih Roemen dhe Schmit kundër Luksemburg, nr. 51772/99, 25 maj 2003 § 57; Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës, nr. 33400/96, § 103, 15 tetor 2003; Nagla kundër Letonisë, nr. 73469/10, 16 tetor 2013, § 95; dhe Görmüş dhe të tjerët kundër Turqisë, nr. 49085/07, § 73, 19 janar 2016). Përfundime të ngjashme u arritën nga Gjykata në një rast ku sekuestrimi gjithashtu kishte të bënte, ndër të tjera, me të dhënat e komunikimit të gazetarëve (shih Ressiot dhe të tjerët kundër Francës, nr. 15054/07 dhe 15066/07, 28 shtator 2012, §125)».»*

Ndërhyrja në të drejtat e ankuesit në çështjen në fjalë është e një natyre shumë më serioze se rasti *Sedletska kundër Ukrainës* apo edhe rasti *Shkullaku dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (i cili shërbeu si rasti praktik për të shtyrë Gjykatën e Lartë të merrte Vendimin Njësues nr. 147, datë 23.12.2021).

Ndërsa në rastin e parë gjykata urdhëroi zbulimin e të dhënave të mbrojtura te gjeolokacioni i aplikantes për një periudhë 16-mujore, në rastin Qyno, SPAK autorizoi kërkimin dhe sekuestrimin e të gjitha pajisjeve dhe të dhënave elektronike të ankuesit në shtëpi, automjet, vendin e punës, në personin e tij, si dhe në personat që punojnë në redaksi, pa përcaktuar periudhë kohore të të dhënave dhe **duke e ekspozuar ankuesin me të gjitha të dhënat që dispononte në këto pajisje, disa prej të cilave edhe me karakter krejtësisht privat dhe familjar.**

Telefoni tashmë është një mjet jetese që pasqyron çdo lloj veprimtarie që kryen çdo shtetas në përditshmërinë e tij dhe për sa kohë që nuk ka modalitete specifike se çfarë do të kontrollohet nga objektet e sekuestruara dhe mënyrën se si do të kryhet ky kontroll, nënkuptohet që personi i nënshtrohet kontrollit të të gjithë jetës së tij, duke iu cënuar në këtë mënyrë e drejta për një jetë private dhe familjare.

Rasti Qyno është më serioz se rasti *Shkullaku* (Lapsi.al) sepse në atë rast u urdhërua sekuestrimi i mjeteve të punës, por jo ato personale në shtëpi përmes kontrollit të banesës dhe pa praninë e një mbrojtësi. Madje, në rastin aktual, sekuestrimi ka ndodhur, ndryshe nga rasti Shkullaku ku sekuestrimi nuk u realizua si veprim sepse u urdhërua pezullimi i tij nga GJEDNJ, në zbatim të Rregullit 39 të Gjykatës.

Në rastin konkret, gazetari Elton Qyno nuk iu dha as mundësia të ankimonte efektivisht në zbatim të Rregullit 39<sup>43</sup> (për të urdhëruar pezullimin e sekuestrimit), pasi sekuestrimi ndodhi përmes një operacioni blic, ndërsa ai mbahej i izoluar në ambientet e SPAK.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit vlerëson se praktika e GJEDNJ nga SPAK duhet të trajtohet si në frymën e vendimit ashtu edhe (në masën përkatëse) dhe kjo frymë duhet të formësojë punën e autoritetit shtetëror (prokurorisë dhe gjykatës) për të zbatuar thelbësisht të drejtat e njeriut në vend.

---

<sup>43</sup> Neni 39 i Rregullores së GJEDNJ “Masat e përkohshme” parashikon:

1. Gjykata mundet, në rrethana të jashtëzakonshme, qoftë me kërkesë të një pale apo të ndonjë tjetër personi të interesuar, ose me nismën e saj, t’u kërkojë palëve çdo masë të përkohshme që e konsideron se duhet miratuar. Masa të tilla, të zbatueshme në rastet e rrezikut të afërt të cënimit të pariparueshme të një të drejte të Konventës, e cila, për shkak të natyrës së saj, nuk do të ishte e mundur të dëmshpërblehej, të vendosej në vend ose të kompensohej në mënyrë të arsyeshme, mund të miratohet kur është e nevojshme në interes të palës ose zhvillimit të duhur të procedurës.
2. Kompetenca e Gjykatës për të vendosur për kërkesat për masa të përkohshme ushtrohet nga gjyqtarët e gatshëm të emëruar në përputhje me paragrafin 5 të kësaj rregulle ose, kur është rasti, nga Kryetari i Seksionit, Dhoma, Kryetari i Dhomës së Madhe, Dhoma e Madhe ose Kryetari i Gjykatës.
3. Kur konsiderohet e përshtatshme, njoftimi i menjëhershëm i masës së miratuar në një rast të caktuar mund t’i jepet Komitetit të Ministrave.
4. Një gjyqtar i gatshëm i emëruar në përputhje me paragrafin 5 të këtij rregulli ose, kur është rasti, kryetari i Seksionit, Dhoma, Kryetari i Dhomës së Madhe, Dhoma e Madhe ose Kryetari i Gjykatës mund të kërkojë informacion nga palët për çdo çështje që lidhet me zbatimin e çdo mase të përkohshme të diktuar.
5. Kryetari i Gjykatës emëron nënkryetarët e seksioneve si gjyqtarë të gatshëm për të vendosur mbi kërkesat për masa të përkohshme.

Për më tepër shih Rregulloren e GJEDNJ: [https://ëëë.echr.coe.int/documents/d/echr/rules\\_court\\_eng](https://ëëë.echr.coe.int/documents/d/echr/rules_court_eng)

Në çështjen *Avaz Zeynalov kundër Azerbaixhanit* (Aplikimi nr. 37816/12 dhe 25260/14, vendim i datës 22 Prill 2021), GJEDNJ thekson se rëndësi ka mundësia e krijuar organit të hetimit, edhe nëse qëllimi nuk është zbulimi i burimit të gazetarit. Sipas Gjykatës:

*«104... Gjykata konsideron se, edhe duke supozuar se qëllimi i kontrolleve dhe sekuestrimeve nuk ishte zbulimi i burimeve gazetareske, siç pretendohet nga Qeveria, formulimi i urdhrit ishte qartësisht shumë i gjerë për të përjashtuar këtë mundësi dhe bastisjet e konfiskimet ishin joproporcionale për sa i dhanë mundësi autoriteteve hetuese të kontrollonin burimet gazetareske të ankuesit (shih Saint-Paul Luxembourg SA, cituar më lart, § 61).»*

GJEDNJ, në të njëjtën çështje shprehet edhe lidhur me zgjerimin e efekteve negative të këtyre veprimeve:

*«105...Autoritetet hetuese sekuestruan dokumente dhe sende të shumta që nuk kishin lidhje me hetimin e vazhdueshëm penal, por të afta të çonin në identifikimin e burimeve gazetareske të ankuesit...*

*106. Gjykata e konsideron të nevojshme të përsërisë se sekuestrimi i shumë dokumenteve dhe sendeve qartësisht të palidhura me procedurat penale në vazhdim kundër ankuesit gjatë kontrolleve në shtëpinë dhe vendin e punës jo vetëm që kishte një ndikim shumë negativ në marrëdhëniet e tij me burimet e informacionit, por edhe ka një efekt parandalues, në përgjithësi, mbi gazetarët e tjerë dhe burimet e tyre gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre (shih Görmüş dhe të tjerët, cituar më lart, §§ 73-74).»*

Në krahasim me rastin *Avaz Zeynalov*, në çështjen aktuale ka ndodhur pikërisht që urdhëri i gjykatës është formuluar në terma të gjerë dhe ka lejuar një sekuestrim në terma të gjerë, duke mundësuar jo vetëm sekuestrimin e çdo pajisjeje elektronike, por edhe i ka mundësuar hetuesve që të zbulojnë burimet, edhe sikur këta të mos kenë tendencën për t'i parë ato. Kontrolli i kryer pa praninë e avokatit dhe aksesit i të dhënave më pas, pa praninë e vetë personit dhe avokatit, do e përkeqësojë situatën, duke sjellë një dëm shumë të rëndë dhe mbi të gjitha, të pariparueshëm, pasi çënohet jeta private në

kushtet kur në përmbajtjen e sendeve të sekuestruara ka informacione të të gjithë jetës së ankuesit dhe familjes së tij.

Në çështjen *Särgava kundër Estonisë* (Aplikimi nr. 698/19, vendim i datës 16 Nëntor 2021), në një rast që kishte të bënte me privilegjin e sekretit profesional të një avokati (për të cilin zbatohen parime të ngjashme me rastin aktual), GJEDNJ u shpreh se:

*”68...Formulimi i nenit 83 të KPP më tepër i referohet diskrecionit të autoriteteve hetuese në këtë çështje. Për më tepër, Qeveria nuk ka dhënë asnjë shembull që kjo dispozitë të jetë interpretuar dhe zbatuar në mënyrë që të përmbajë një të drejtë subjektive që aplikanti të jetë i pranishëm gjatë ekzaminimit të përmbajtjes së bartësve të të dhënave. Kështu, thjesht mundësia e paraqitjes së një kërkesë për këtë qëllim nuk mund të konsiderohet një mjet juridik efektiv të cilin kërkuesi pritët të shterojë. Gjykata vëren më tej se ligji i brendshëm nuk specifikon se si prania e kërkuesit -edhe nëse do t'i jepej mundësia- do ta kishte mundësuar atë të parandalonte autoritetet që të ndërhyjnë në privilegjin e tij profesional ligjor...*

*101. Gjykata thekson se detyrimi i avokatit sipas ligjit të brendshëm për të ndarë bartësit e të dhënave të përdorura në ofrimin e shërbimeve ligjore dhe detyrimi për të përdorur struktura të katalogut të shënuar qartë për dosjet e klientëve, nëse ndiqen siç duhet, do të kontribuonte në mënyrë të konsiderueshme në kryerjen e detyrës së shoshitjes së të dhënave.<sup>44</sup>*

*106. Përkundrazi, duket se vendimi nëse do të kryhej një kërkim i bazuar në fjalë kyçe (ose do të përdorej ndonjë metodë tjetër e analizës), si dhe zgjedhja e fjalëve kyçe përkatëse u ishte lënë tërësisht autoriteteve hetimore. Në këtë pikë, Gjykata vëren se disa nga fjalët kyçe të përdorura për kërkimin (të tilla si "viti financiar" ose "linja e kredisë") ishin dukshëm të gjera në shtrirje. Gjykata ka gjetur tashmë më lart se ligji i brendshëm nuk i jepte kërkuesit asnjë të drejtë për të qenë i pranishëm gjatë kërkimit të bazuar në fjalë kyçe (shih paragrafin 68 më lart).”*

---

<sup>44</sup> Sifting procedure

Në rastin për të cilin është kryer hetimi administrativ nga ana jonë, është tejkaluar dukshëm masa në krahasim me jurisprudencën e mësipërme, në çështjen *Särgava*. Ankuesit nuk i është dhënë asnjë mundësi të jetë prezent në shoshitjen e të dhënave, pasi pajisjet janë tërësisht në dorën e autoriteteve të hetimit, të cilët do të hyjnë pa kufizim të shprehur tek të gjitha të dhënat, duke u nisur edhe nga natyra e gjerë e urdhërit të gjykatës për sekuestrimin e të dhënave elektronike.

Në dispozitat përkatëse procedurale duhet të ketë një parashikim të detajuar se si do të realizohet kqyrja, modalitete shumë specifike të cilat të mbrojnë jetën private të personit të cilit i është sekuestruar pajisja, prania e detyrueshme e mbrojtësit dhe vetë personit gjatë kqyrjes etj.

Në çështjen *Sergey Sorokin kundër Ruisë* (aplikimi nr. 52808/09, vendim i datës 30 Gusht 2022), Gjykata shprehet se:

*”61...Prandaj, ajo e kufizoi shqyrtimin e saj në shqyrtimin e ligjshmërisë formale të kontrollit në vend që të vlerësonte domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e veprimeve të autoriteteve hetuese. Parashtrësat e Qeverisë konfirmojnë konstatimin e mësipërm.*

*62. Për më tepër, ndërsa autorizonte masat e kontrollit dhe sekuestrimit, Gjykata e Qytetit nuk udhëzoi autoritetet hetuese të përdornin ndonjë procedurë analize ose të siguronin ndryshe që informacioni personal dhe profesional i kërkuesit që nuk kishte lidhje me të, nuk aksesohet nga autoritetet. As Gjykata e qytetit nuk dha ndonjë arsye specifike për konstatimin e saj se një kërkim i të gjitha të dhënave të kërkuesit ishte i nevojshëm për hetimin (shih, mutatis mutandis, Robathin kundër Austrisë, nr. 30457/06, § 52, 3 korrik 2012).*

*63. Formulimi i urdhrit të kontrollit pasqyrohej në mënyrën se si u ekzekutua. Hetuesi sekuestroi të gjitha pajisjet elektronike të kërkuesit, kompjuterin e tij dhe katër hard disqet, të cilat duhet të përmbajnë informacione që nuk kanë lidhje me çështjen penale. Nuk ka asgjë që të tregojë se tërësia e atij informacioni nuk është aksesuar menjëherë nga autoritetet hetimore në mungesë të ndonjë procedure analize ose metodave të tjera që mund të*

*mbronin konfidencialitetin e burimeve gazetareske të kërkuesit dhe të informacioneve të tjera që nuk lidhen me çështjen penale kundër Z. L.”.*

Në lidhje me këtë pjesë të jurisprudencës, në çështjen *Sergey Sorokin*, GJKKO në rastin aktual, nuk ka marrë asnjë masë për të udhëzuar hetuesit se çfarë duhet të aksesojnë konkretisht. Gjykata e ka autorizuar aksesin e SPAK dhe i ka dhënë mundësinë pa asnjë kufizim që të sekuestrohen mjetet elektronike të punës së gazetarit pa bërë një procedurë analize, apo çdo metodë tjetër për të mbrojtur konfidencialitetin e burimeve gazetareske dhe informacioneve që nuk lidhen me çështjen.

Për këto arsye, ekziston një rrezik real që organi i akuzës të ketë akses në aspekte të tjera të punës së ankuesit Elton Qyno dhe medias Ora News, pa asnjë lidhje me çështjen në fjalë.

Në mënyrë të ngjashme, përveç disa referencave të paqarta dhe formuluese të dispozitave ligjore përkatëse, vendimet e të dyja gjykatave nuk bëjnë ndonjë referencë se përse një masë e tillë gjithëpërfshirëse ishte e nevojshme dhe proporcionale me interesin e pretenduar publik.

Vendimet nuk bëjnë referencë për ndonjë masë alternative që mund dhe duhej të ishte marrë në hetim, apo pse kjo masë nuk është efektive (si p.sh. hetimi brenda vetë SPAK dhe personave që kanë qenë të autorizuar për të disponuar mbi dosjen se nga ka rrjedhur informacioni si në çështjen *Girleanu kundër Rumanisë*, nr. 50376/09, (vendim i datës 26 Qershor 2018).

Natyrshëm, krijohet dyshimi se në të vërtetë, veçimi vetëm i ankuesit për zbatimin e një mase të tillë dhe dështimi i autoriteteve për të zbatuar masa alternative hetimore duket se nuk është vetëm për të zbuluar burimin e rrjedhjes së informacionit, por për të ndëshkuar ankuesin për botimin e artikujve, një masë me efekt të dukshëm *frikësues/frenues* jo vetëm për vetë gazetarin ankues, por të gjithë gazetarët e tjerë në Shqipëri.

Ndërkohë ngrihen edhe dyshime serioze që veprimet e shpejta, disa pa urdhër konkret gjykate, mund të jenë bërë për të kuptuar se deri ku është shtrirë dijenia e gazetarit mbi komunikimet e aplikacionit të enkriptuar SkyECC ku dyshohet se janë përfshirë një mori personash të botës së krimit, por jo vetëm,

duke ngritur dyshime të forta për përfshirjen edhe të personave të lidhur me politikën, biznesin apo median.

Ne vlerësojmë se nga dokumentacioni që administrojmë dhe informacioni që kemi, nuk u provua të kishte ndonjë urgjencë për marrjen e këtyre masave ndaj gazetarit Qyno si nga SPAK, ashtu edhe nga GJKKO dhe për më tepër pa e dëgjuar atë, ndonëse ai ndodhej në ambientin e këtyre strukturave. Atij nuk iu dha mundësia e dëgjimit dhe mbrojtjes para gjykatës dhe nuk rezulton që të jetë bërë ndonjë analizë nga këto struktura për të kryer këtë mënyrë gjykimi pa praninë e tij/versus të zakonshëm. Avokati i Popullit vëren se jo rrallë herë përjashtimet bëhen rregull në dëm të individit, duke i cenuar rëndë të drejtat, liritë dhe interesat ligjore.

Ndërkohë që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 17 parashikon se, **çdo kufizim i të drejtave dhe lirive të njohura në Kushtetutë mund të vendoset vetëm me ligj, të jetë proporcional, por edhe me masa më pak të dëmshme për interesat e qytetarëve. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.**

Qëllimi kryesor i ankuesit (në pamje të parë) ka qenë dhe mbetet informimi i publikut se komunikimet në SkyECC përmbajnë të dhëna serioze të kriminalitetit dhe se gazetari ka akses në këto të dhëna duke ushtruar trysinë mbi prokurorët për t'i trajtuar me seriozitet këto komunikime. Nëse gazetari humbet aksesin në këto të dhëna dhe burimi dekonspirohet, komunikimet e SkyECC nuk do të mund të jenë objekt i monitorimit të medias si "watchdog".

Siç rezulton nga jurisprudenca e GJEDNJ, sekuestrimi i pajisjeve mund të bëhet vetëm nëse rrethana e paraqet këtë veprim si të domosdoshëm dhe si **rruga e vetme** e mbërritjes tek e vërteta, kur të gjitha **mundësitë e tjera janë ezaauruar** ose nuk janë efektive. Sekuestrimi duhet të jetë proporcional, pra **të shtrihet në sa më pak të dhëna** dhe jo të përfshijë një mori pajisjesh, por vetëm të aksesohen aq sa duhen për të arritur marrjen e informacionit **pa rrezikuar zbulimin e të dhënave që shpien te burime të tjerë**, gjithmonë kur mbetet opsioni i vetëm i hetimit pas dështimit të të gjitha rrugëve të tjera.



Sekuestrimi është masa më ekstreme (*extrema ratio*). Në praktikë, në kohët e teknologjisë moderne, është tepër e vështirë të mos ekzistojnë një mori mjeteve e teknikash të tjera për hetimin, duke e bërë praktikisht të pazbatueshme këtë masë ekstreme në kushtet e hetimit nr. 245/2023 të SPAK.

E gjithë kjo analizë duhej të ishte bërë nga Gjykata e Posaçme e të dyja shkallëve, por dukshëm nga organet e specializuara nuk është vlerësuar rëndësia e garancive të parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për sa kohë që telefoni është „jeta digjitale” e njeriut në ditët e sotme.

Përveç sa më sipër, nga SPAK dhe nga të dy Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e të dy shkallëve nuk vlerësohet se kjo veprimtari ka garantuar parashikimet e Vendimit Njësues, nr. 147, datë 23.12.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në të cilin është theksuar se:

*“75. Në rastin specifik të gazetarëve profesionistë, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike kërkon një vëmendje të veçantë, pasi përbën një rrezik të dukshëm për zbulimin e burimit të informacionit. Lidhur me rëndësinë e ruajtjes së burimit të informacionit, në çështjen Goodëin v. The United Kindom, App. no. 17488/90, 27.3.1996, GJEDNJ ka konkluduar se kërkesa e autoriteteve drejtuar gazetarëve për të zbuluar burimin e informacionit përbën shkelje të lirisë së shprehjes. Po ashtu, sipas GJEDNJ, në çështjen Roemen e Schmit v. Luxembourg, App. no. 51772/99, 25.5.2003, shkelje edhe më të rëndë përbëjnë kontrollet, edhe nëse nuk kanë rezultat, të cilat kanë për objekt zbulimin e identitetit të burimit të provës. Sipas Gjykatës së Strasburgut, mbrojtja e burimit të gazetarëve përbën një nga shtyllat e lirisë së shprehjes, pa të cilën këto burime mund të mos e ndihmojnë shtypin të informojë publikun për çështje të interesit të përgjithshëm. Për rrjedhojë, shtypi mund të mos jetë në gjendje të kryejë rolin e tij në ofrimin e informacioneve të sakta e të besueshme.*

*76. Në përputhje me këtë qëndrim të GJEDNJ, Kolegji vlerëson se, sikundër u aryetua më lart, përveç garancive të parashikuara lidhur me sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, specifikisht lidhur me sekuestrimin e të dhënave*

ose sistemeve kompjuterike ndaj gazetarëve profesionistë, Gjykata duhet të lejojë sekuestrimin, **pasi të jetë shteruar kërkimi në të gjitha burimet e tjera të mundshme të të dhënave**, duke pasur parasysh paragrafin 3 të nenit 159 të KPP, i cili parashikon lidhur me emrat e personave nga të cilët gazetarët profesionistë kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre dhe **vetëm kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit**, Gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij. Kjo do të thotë se ndërhyrje të tilla, duhet të jenë të mirëargumentuara dhe **vetëm në rastet kur e dhëna nuk mund të merret në mënyrë tjetër**.

77. Sa më sipër, lidhur me çështjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:

Së pari, duhet të ekzistojnë kushtet e përgjithshme sipas nenit 208 KPP:

i. Kjo do të thotë se sekuestrimi edhe në rastin e të dhënave kompjuterike, vendoset për provat materiale, kuptimi i të cilave jepet në nenin 187 të KPP dhe për sendet që lidhen me veprën penale.

ii. Për sendet që lidhen me veprën penale, duhet të arsyetohet se edhe këto sende janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.

Së dyti, Gjykata duhet të argumentojë se cila është vepra penale që në mënyrë të arsyeshme dyshohet se është kryer.

Së treti, Gjykata duhet të arsyetojë përse sekuestrimi i të dhënave ose sistemeve kompjuterike është i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes.

Së katërti, Gjykata duhet të përcaktojë ose të argumentojë se **cilat janë të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe çfarë synohet të provohet nëpërmjet vendosjes së sekuestros mbi të dhënat ose sistemet kompjuterike**. Në këtë përcaktim **Gjykata duhet të bazohet në parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë, duke lejuar sekuestrimin e të dhënave ose të sistemeve kompjuterike për nevoja të hetimit, vetëm nëse është e nevojshme, për sa është e nevojshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme;**

*Së pesti, Gjykata duhet të përcaktojë dhe të arsyetojë në vendim modalitetet për sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Edhe në këtë rast, Gjykata duhet të bazohet në parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë. Sekuestrimi duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të sekuestrohen vetëm të dhënat ose sistemet specifikisht të përcaktuara në vendimin e gjykatës. Për nxjerrjen e të dhënave mund të sekuestrohen pajisjet, vetëm në rast se është e domosdosme dhe për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e të dhënave apo krijimin e kopjeve;*

*Së gjashti, përveçse sa më sipër, specifikisht lidhur me sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike ndaj gazetarëve profesionistë, Gjykata duhet të lejojë sekuestrimin, pasi të jetë shteruar kërkimi në të gjitha burimet e tjera të mundshme të të dhënave, duke patur parasysh paragrafin 3 të nenit 159 të KPP. Kjo do të thotë se ndërhyrje të tilla, duhet të jenë të mirëargumentuara dhe vetëm në rastet kur e dhëna nuk mund të merret në burimin e saj. Në raste të tilla përjashtimore, Gjykata duhet të saktësojë të dhënat konkrete që kërkohet të sekuestrohen, përse ato janë të domosdoshme/thelbësore për zgjidhjen e çështjes sipas nenit 211/2 të KPP, si dhe arsyet përse sekuestrimi i tyre është i pamundur të realizohet në një mënyrë tjetër. Në çdo rast Gjykata duhet të tregojë kujdes për moscenim të marrëdhënies së gazetarit me burimin e informacionit, duke shmangur zbulimin e këtij burimi kur vërtetësia e të dhënave mund të verifikohet në një mënyrë tjetër.*

Mbrojtja e burimeve të gazetarëve është gur themeli i lirisë së shtypit. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, e drejta e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre nuk është privilegj i thjeshtë për t'u dhënë ose marrë në varësi të ligjshmërisë ose paligjshmërisë së burimeve të tyre, por është pjesë kyçe e të drejtës për informim, për t'u trajtuar me kujdes maksimal.

Pa mbrojtje efektive, burimet mund të dekurajohen që të ndihmojnë shtypin për të informuar publikun për çështje me interes publik. Si pasojë mund të minohet roli jetik i "mbikëqyrësit publik" të shtypit. Çdo ndërhyrje në të drejtën për mbrojtje të burimeve gazetareske (bastisjet në vendin e punës ose shtëpinë e gazetarëve, konfiskimi i materialit gazetaresk, urdhëra për zbulim, etj.) që mund të çojë në identifikimin e tyre, duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse efektive procedurale ligjore që janë proporcionale me rëndësinë e

parimit të rrezikuar. E para dhe më e rëndësishmja nga këto masa mbrojtëse është garancia e shqyrtimit nga një organ i pavarur dhe i paanshëm për të parandaluar qasjen e panevojshme në informata të cilat mund të zbulojnë identitetin e burimeve. Një shqyrtim i tillë është parandalues për nga natyra. Organi i rishikimit duhet të jetë në gjendje të peshojë rreziqet e mundshme me interesat përkatëse para se të bëhet ndonjë zbulim. Vendimi i tij duhet të drejtohet nga kritere të qarta, përfshirë nëse masat më pak ndërhyrëse do të mjaftonin. Urdhërat e zbulimit ndaj gazetarëve kanë ndikim të dëmshëm jo vetëm për burimet e tyre, identiteti i të cilave mund të zbulohet, por edhe për gazetën kundër së cilës drejtohet urdhëri, reputacioni i së cilës mund të dëmtohet në sytë e burimeve të ardhshme të mundshme, madje edhe për publikun e gjerë që ka interes të marrë informacione të siguruara përmes burimeve anonime dhe që mund të jetë vetë burim i informatave. Duke patur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së burimeve gazetareske për lirinë e shtypit në një shoqëri demokratike dhe efektin potencialisht frikësues që një urdhër për zbulimin e burimit të tyre e ka në ushtrimin e asaj lirie, një masë e tillë nuk mund të jetë në përputhje me Nenin 10 të Konventës, përpos nëse ajo justifikohet nga një kërkesë më e rëndësishme për interesin publik.

**Avokati i Popullit çmon se për shkak të këtyre veprimeve (sekuestrimit të pajisjeve elektronike si të telefonave dhe kompjuterave) rrezikohen edhe të dhënat konfidenciale profesionale dhe private të gazetarit Elton Qyno.**

Kjo mund të sjellë si pasojë që ai të jetë në një përgjim të përhershëm për shkak të të dhënave konfidenciale që ka të ruajtura në këto pajisje, të dhëna këto të krijuara në kohë të ndryshme dhe që nuk kanë aspak lidhje me shkakun e kontrollin, por i përkasin të dhënave personale që gëzojnë mbrojtje nga kushtetuta dhe legjislacioni i brendshëm dhe ndërkombëtar.

Siç u dekonspiruan të dhënat e sekretit hetimor, që u bënë shkak i kontrollit dhe sekuestrimit ndaj gazetarit, mund të dalin sërish edhe të dhënat e sekustruara gazetarit Qyno dhe potencialisht mund të përdoren në të ardhmen me qëllim jo të ligjshëm ndaj tij, për t'a shantazhuar atë si gjatë ushtrimit të profesionit ashtu edhe në jetën private.

**Kjo do të përbënte shkelje të nenit 8<sup>45</sup>, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”.**

Theksojmë se, ky veprim cenon thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe ka tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, respektivisht nenin 8 për respektimin e jetës private.

Për këtë çështje kaq sensitive, është shprehur qartë dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, që ka vënë theksin në domosdoshmërinë e kontrollit gjyqësor, qoftë *ex ante*, apo *ex post*, në çështjet Szabo dhe Vissy kundër Hungarisë<sup>46</sup>, apo në çështjen Zakharov kundër Rusisë<sup>47</sup>.

Edhe në rastet kur organeve ligjzbatuese u njihet e drejta të përdorin mjetet e mbikëqyrjes së veçantë, ligji duhet të përcaktojë standardet minimale që garantojnë shmangien e abuzimeve, duke filluar që nga lloji i veprave penale për të cilat mund të kryhet mbikëqyrja e gjurmimi, statusi që duhet të ketë **subjekti që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes a gjurmimit, kufizimet kohore për këtë veprimtari, e deri te procedura se si duhet trajtuar informacioni i marrë nga mbikëqyrja a gjurmimi, deri në asgjësimin e sigurt të tij.**

Kjo lloj veprimtarie gjurmuese, e cila parashikohet në dispozitat e K.Pr.Penale, është një veprimtari që mund të kryhet vetëm për qëllime madhore të sigurisë kombëtare dhe nga strukturat përkatëse që ka shteti shqiptar dhe në çdo rast, duhet t'i nënshtrohet rregullave të posaçme procedurale.

Edhe vetë Kodi i Procedurës Penale, në lejimin e përgjimit dhe të gjitha formave të tij (përfshirë mbikëqyrjen dhe gjurmimin), bën një kategorizim të

---

<sup>45</sup> Neni 8 parashikon se:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

<sup>46</sup> Case of Szabó and Vissy v. Hungary (Application No. 37138/14)

<sup>47</sup> Case of Roman Zakharov v. Russia (Application no. 47143/06)

Ilojit të veprave penale për të cilat lejohet ky veprim procedural, në varësi të rrezikshmërisë shoqërore që ato paraqesin.

Në këtë kuadër vlen të sjellim në vëmendje çështjen *Avaz Zeynalov kundër Azerbajxhanit*, në të cilin GJEDNJ shprehet:

*«78. Gjykata konstaton, pa pasur debat mes palëve, se... sekuestrimi i materialeve të ndryshme përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së ankuesit për të respektuar jetën e tij private dhe familjare brenda kuptimit të Nenit 8 §1 të Konventës (shih *Saint-Paul Luxembourg SA kundër Luksemburgut*, nr. 26419/10, §§ 37-39, 18 Prill 2013; *Amarandei dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 1443/10, § 215, 26 Prill 2016; *Aliyev kundër Azerbajxhanit*, nr. 68762/14 dhe 71200/14, § 178, 20 Shtator 2018; dhe *Yunusova dhe Yunusov k. Azerbajxhan (nr. . 2)*, nr. 68817/14, § 148, 16 korrik 2020). Gjithashtu, i padiskutueshëm nga palët është edhe fakti që automjeti në të cilin u krye kontrolli dhe sekuestrimi kishte qenë në përdorim të ankuesit dhe Gjykata vlerëson se kontrolli dhe sekuestrimi i kryer në atë automjet gjithashtu përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së kërkuesit për jetën e tij private brenda kuptimit të Nenit 8 § 1 të Konventës (shih *Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës*, nr. 33400/96, § 110, 15 korrik 2003)».*

Në rastin në fjalë, veprimet e kontrollit dhe të sekuestrimit çënojnë të drejtat e gazetarit për jetën e tij private, të garantuara nga neni 37 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ. Sekuestrimi i pajisjeve elektronike krijon mundësi për aksesin në sekrete personale të jetës private, por edhe në sekrete profesionale, për shkrime që ankuesi dhe media ku ai punon, mund të jenë duke përgatitur (që mund të gjenden në formën e drafteve), ose informacioneve të tjera, ende të papërpunuara që mund të gjenden në memorien e kompjuterave, serverave, telefonave, USB-ve, CD-ve, etj. Jeta profesionale mbrohet njëjloj sikurse edhe jeta private nga neni 8 i KEDNJ-së.

Ndërkohë, sekuestrimi i pajisjeve rrezikon edhe mos ushtrimin e profesionit të gazetarit nga ankuesi, sepse mjetet kryesore të punës së tij janë pikërisht pajisjet elektronike. Në kompjuterat e sekuestruar ai pretendon se ka punime të ndryshme dhe madje kompjuterin e shtëpisë e përdorin edhe fëmijët e mitur për detyrat e shkollës apo edhe për argëtim.

Ankuesi ka ngritur shqetësimin se pas sekuestrimit të pajisjeve më dt.13.12.2023, është abandonuar nga burimet e informacionit dhe nuk ka mundur të kontaktojë ato dhe se këta të fundit nuk kanë dëshirë të bashkëpunojnë me të në cilësinë e gazetarit. Kjo situatë ka dëmtuar ndjeshëm aftësitë e tij për të kryer funksionin e gazetarit dhe informimin e publikut.

Po ashtu ai referon edhe se një situatë frike dhe rënie e rendimentit është raportuar në këtë kohë edhe nga kolegë të tjerë gazetarë, të cilët nuk ndjehen të sigurt në punën e tyre. Për sa më sipër, duhen vlerësuar nga prokuroritë dhe gjykatat në vijimësi rastet e kryerjes së këtyre veprimeve, duke treguar kujdes permbajtësor sa i takon proporcionalitetin e domosdoshmërisë së ndërhyrjes në raste të tjera.

### **Vlerësimi i një konflikti të mundshëm për trajtimin e rastit**

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, kemi konstatuar se SPAK ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe ekziston rreziku serioz për prishjen e të dhënave.

Sipas vendimeve gjyqësore rezulton se veprat penale që po hetohen në kuadër të procedimit nr. 245/2023 "Zbulim i akteve ose të dhënave sekrete" dhe "Ndalim i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin", parashikuar nga nenet 295/a, paragrafi 3 dhe 313/b, pika 1, të Kodit Penal kanë si subjekt të posaçëm *prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore që kanë operuar me procedimin penal nr.75/2022.*

Sikurse rezulton nga vetë vendimet gjyqësore, SPAK ka bashkuar procedimin penal nr. 75/2022 (dosja nga kanë rrjedhur informacionet) me procedimin nr. 245/2023 (dosja që heton rrjedhjen e informacioneve nga vetë prokurorët e dosjes nr. 75/2022). **Pra, prokurorët e procedimit penal nr. 75/2022 tashmë janë duke hetuar veten, kolegët dhe OPGJ-të në varësi të tyre.** Këtu lind dyshimi i arsyeshëm, a do të jenë ata objektivist të pavarur kur hetojnë veten, kolegët, apo OPGJ-të, në varësi të tyre dhe a ekziston mundësia që përgjegjësia reale për autorin e mundshëm, të mos evidentohet për shkak të këtij konflikti interesi të dukshëm?!

Sqarojmë se, vepra penale e parashikuar nga neni 313/b i Kodit Penal nuk është në kompetencën lëndore të SPAK. Sipas nenit 74 të K.Pr.Penale, gjykata kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjithashtu, vepra penale e parashikuar nga neni 313/b i Kodit Penal, për sa kohë nuk ka sjellë asnjë pasojë, mbetet në paragrafin e parë të këtij neni dhe përbën kundravajtje penale. Kjo e fundit nuk është vepër penale e tillë që të legjitimojë sekuestrimin e të dhënave elektronike, të cilat sekuestrohen vetëm kur hetohet për një krim.<sup>48</sup>

---

<sup>48</sup> Lidhur me këtë problematikë GJEDNJ në çështjen (*Enukidze dhe Girgvliani kundër Gjeorgjisë, Ap. nr. 25091/07, 26 Prill 2011*), ngriti shqetësimin për konfliktin e interesit në hetim, duke u shprehur se:

246. *Megjithatë, edhe pse këto rrethana implikojnë përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme në fazën e hershme të hetimit, i njëjti autoritet vazhdoi të ishte në krye të hetimit për një periudhë të konsiderueshme kohore, deri më 5 mars 2006 (shih paragrafin 49 më lart). Gjatë kësaj periudhe, Ministria zhvilloi veprime hetimore të rëndësishme, siç ishin pyetjet e dëshmitarëve të rëndësishëm, mbledhja e të dhënave për numrat e telefonave celularë që ishin në komunikim në kohën e materialit përmes antenave të ndërlidhura në Tbilisi, përfshirë, siç u nënvizua më lart, numrat e zyrtarëve të Ministrisë të interesuar, sekuestrimi i regjistrimit nga kamera e mbikëqyrjes në rrugën Tbilisi-Kojori, i cili më vonë u bë dëshmi e rëndësishme për verifikimin e përfshirjes së pretenduar të O.M.-ov, dhe kështu me radhë (shih paragrafët 24-48).*

247. *Kjo lidhje institucionale dhe nën-hierarkike midis zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Brendshme të përfshirë dhe hetuesve në ngarkim të rasti është edhe më e dukshme kur vlerësohet fakti që D.A., një pjesëtar i grupit të gruas së Ministrit në kafene dhe, në të njëjtën kohë, drejtpërsëdrejti përgjegjës për G.A., ishte më vonë personi përgjegjës në Ministri për hetimin e vdekjes së Sandro Girgvliani. Papërshtatshmëria e konfliktit të interesit ishte, në sytë e Gjykatës, akoma më e theksuar nga fakti që ajo u fsheh nga opinioni publik: përmendja e vetme e përfshirjes së D.A. në hetim u shfaq në memorandumet e Ministrisë të 24 shkurt 2006, dokument i brendshëm i klasifikuar në atë kohë (shih paragrafët 10 dhe 50-52 më lart).*

248. *Përmbajtja e këtij memorandumit konfirmon edhe më tej se, të paktën më 2 shkurt 2006, D.A. tashmë dinte për përfshirjen e mundshme të kolegëve të tij në krim, megjithatë nuk u tërhoq nga rasti. Po ashtu, nëse deklaratat e D.A. mund të besohen, Gjykata është e tronditur nga fakti që edhe Ministri i Brendshëm, pas mësimit të fakteve që përfshinin vartësit e tij dhe ndoshta gruan e tij, nuk e hoqi menjëherë dosjen nga duart e Ministrisë, çka do të ishte zgjidhja e vetme profesionale dhe e diskrecionit në këto rrethana, por, në të kundërt, udhëzoi D.A. që të vazhdojë hetimin (shih paragrafin 116 më lart).*

249. *Në dritën e mësipërme, Gjykata gjen se hetimi i kryer nga Ministria e Brendshme ndërmjet 26 janarit dhe 5 mars 2006, gjatë kohës së të cilës u mblodhën dëshmitë vendimtare, mungonte qartësisht pavarësia dhe paanshmëria e kërkuar, mungesë procedurale e cila dëmtoi zhvillimet e mëvonshme të hetimit (shih Kolevi k. Bullgarisë, nr. 1108/02, §§ 208 dhe 212, 5 nëntor 2009).*



Avokati i Popullit çmon se shkeljet ligjore, apo devijimi nga zbatimi korrekt i detyrime dhe garancive procedurale të kryera nga SPAK dhe të lejuara apo të mos kontrolluara **nga GJKKO e të dy shkallëve, krijojnë premisa për cënimin e lirisë së shtypit e të medias.**

**E drejta për një seancë të hapur publike dhe pjesëmarrja e Avokatit të Popullit**

**Një nga elementët e tjerë shqetësues që u evidentua gjatë shqyrtimit të ankesës së gazetarit Elton Qyno, është edhe moslejimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesit të Avokatit të Popullit që të ishte i pranishëm në seancën gjyqësore, veprim i cili në vlerësimin tonë përbën cënim të mandatit të këtij institucioni kushtetues.**

Qëndrimi i mbajtur nga GJKKO e Apelit duke mos pranuar përfaqësuesin e institucionit tonë të merrte pjesë në seancën gjyqësore të datës 05.01.2024, është në shkelje të hapur të kuadrit ligjor në fuqi.

Kjo gjykatë duhet të lejonte praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit në sallën e gjykimit dhe vetëm pasi të hapej seanca gjyqësore, të merrte vendimin përkatës për pranimin ose mospranimin e tij si vëzhgues.

Ndërkohë, sqarojmë se para fillimit të gjykimit gjyqtarja e çështjes u informua nga punonjësit e administratës së këtij institucioni (sekretarja dhe koordinatorja) se përfaqësuesi ynë ishte i pajisur me autorizim dhe me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) për t'u njohur me informacionin e klasifikuar "Tepër sekret".

Gjithashtu, edhe pasi u hap seanca gjyqësore, avokati i ankuesit i kërkoi gjykatës që të pranonte kërkesën e tij për të qenë i pranishëm në seancë përfaqësuesi i institucionit tonë, duke e bërë me dije se ai ishte i pajisur me autorizim dhe me CSP.

Në këtë rast edhe prokurori i çështjes ka dhënë pëlqimin e tij lidhur me këtë kërkesë por edhe pas kësaj kërkesë, gjykata ndonëse nuk mori ndonjë vendim, u shpreh se nuk e pranoi kërkesën e avokatit të shtetasit Elton Qyno.

Sistemi i drejtësisë vazhdimisht ka qenë subjekt i kritikave për transparencë të kufizuar dhe llogaridhënie publike të kufizuar, edhe pse aktorët brenda sistemit të drejtësisë deklarojnë se puna e tyre bazohet në këto parime. Në këtë drejtim, krahas pikave të tjera në të cilat sistemi i drejtësisë dështon në zbatimin e parimit të transparencës, janë evidentuar raste të zhvillimit me dyer të mbyllura të seancave të caktuara gjyqësore, informimi për të cilat është i rëndësishëm për publikun, mediat dhe shoqërinë civile.

Në aspektin legjislativ, Shqipëria ka arritur të përafrojë kornizën ligjore lidhur me transparencën dhe publicitetin e punës së gjykatave, në pajtim me praktikën dhe standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Shqipëri apo në të cilat Shqipëria aspiron për t'u anëtarësuar në të ardhmen, si ai i shteteve të Bashkimit Europian.

Në këtë drejtim, praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), jurisprudenca e së cilës në sistemin kushtetues të Republikës së Shqipërisë është e detyrueshme, ka vendosur standarde në këtë fushë.

Në rastin *Malhous kundër Republikës së Çekisë*, GjEDNj ka theksuar rëndësinë që seancat gjyqësore të jenë publike:

*“Gjykata rithekson se mbajtja publike e seancave gjyqësore përbën një parim themelor të sanksionuar në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ. Ky karakter publik i mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur pa shqyrtim publik. Gjithashtu, është një nga mënyrat me anë të së cilës mund të mbahet besimi në gjykata. Duke e bërë administrimin e drejtësisë në mënyrë transparente, publiciteti kontribon në arritjen e qëllimit të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ, që nënkupton një gjykim të drejtë, të pavarur, i cili është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, brenda kuptimit të KEDNJ”.*

GjEDNj- së ka vendosur standarde shumë specifike për të cilat një gjyqtar të vendosë se seanca gjyqësore do të jetë e hapur apo e mbyllur për publikun. Në bazë të nenit 17 të Kushtetutës së Shqipërisë, këto standarde të GjEDNj-së janë të detyrueshme për sistemin e drejtësisë në vendin tonë.

Krahas KEDNJ-së, edhe Karta Europiane për të Drejtat Themelore (KEDTH) përcakton shprehimisht se gjykimi duhet të jetë publik. Një ndër rrugët

kryesore të Republikës së Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian është edhe Marrëveshja për Stabilizim Asociim. Në këtë marrëveshje, përafrimi i legjislacionit të Shqipërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) është njëra ndër kategoritë themelore. Ndër të tjera, kjo marrëveshje përcakton se *“Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Shqipërisë me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkoj gradualisht drejt përputhjes me Acquis-in e BE-së.*

Për këtë arsye, përafrimi i legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe zbatimi i tij me atë të BE-së, është një kusht i domosdoshëm i vendit tonë për avancim të mëtejshëm në rrugën drejt BE-së.

Ndonëse, dispozitat ligjore si ato vendore dhe ndërkombëtare dhe po ashtu edhe praktika e GjEDNj-së i japin rëndësi jetike proceseve gjyqësore të hapura për publikun dhe palët e interesuara, për të siguruar një proces gjyqësor të drejtë, që qëllim final ka fitimin e besimit të publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave, sistemi gjyqësor i Republikës së Shqipërisë rezulton se ende ka qëndrime të uniformësuar për mbajtjen e seancave të mbyllura, veçanërisht në lidhje me masat e sigurisë. Ekziston një numër i caktuar i seancave të natyrës penale në sistemin gjyqësor që mbyllen për publikun nga ana e gjykatësve, dhe në raste të tilla, publiku, media dhe shoqëria civile nuk marrin vendimin për mbylljen e këtyre seancave.

Avokati i Popullit vlerëson se publiciteti i seancave gjyqësore duhet të kuptohet në atë formë që në asnjë rrethanë nuk e dëmton administrimin e drejtësisë. Në të kundërtën, siç e përcakton edhe praktika e GjEDNj-së, ajo i mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur dhe është një nga mënyrat me anë të së cilës mbahet besimi në gjykata.

Gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se publiciteti i seancave gjyqësore, sipas KEDNj-së, është një nga elementët që formëson të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Po ashtu, transparenca e sistemit të drejtësisë nuk është një fakt i mirëqenë, i cili mund të proklamohet në mënyrë të përgjithësuar, pasi për vlerësimin e saj, ka matës shumë specifike. Mungesa

e transparencës më së shumti paraqitet në rastet kur publiku përjashtohet nga përcjellja e seancave gjyqësore, të cilat sipas ligjit janë të hapura, dhe për të cilat publiku ka interes që të informohet.

Një prej parimeve kryesore të gjykimit, është zhvillimi i seancave gjyqësore me dyer të hapura, si një nga kriteret që plotëson gjykimin e drejtë. Ky parim është instaluar në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) e cila përcakton se *“çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm...”*.

Elementi **“publikisht”** në këtë rast, është një nga tri atributet kryesore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Në anën tjetër, praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare, si dhe legjislacioni ynë i brendshëm, përcaktojnë detyrimin që seancat parimisht të jenë të hapura për publikun. Në këtë drejtim, rol kyç ka Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) me anë të jurisprudencës së saj, e cila në sistemin kushtetues të Republikës së Shqipërisë është e obligueshme, pasi ka vendosur standarde në këtë fushë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, garanton të drejtën për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm. Për më tepër, Kushtetuta përcakton garanci ligjore në obligimin e gjykatave për të siguruar gjykim publik.

#### **“Neni 42**

1. *Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.*

2. *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”*

Për këtë arsye, publiciteti i seancave gjyqësore është një parim kushtetues, mos respektimi i të cilit automatikisht nënkupton shkelje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në anën tjetër, edhe Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë përcakton se *“Shqyrtimi gjyqësor është i hapur”*.

### **Neni 339**

Publiciteti i seancës

“1. Seanca gjyqësore është publike, përndryshe quhet e pavlefshme.

2. Nuk pranohen në seancë të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe ata që janë në gjendje dehje, intoksikimi ose çrregullimi mendor.

3. Ndalohet prania në seancë e personave të armatosur, me përjashtim të pjesëtarëve të forcave të ruajtjes së rendit.”

### **Neni 340**

Rastet e gjykimit me dyer të mbyllura

« 1. Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor ose disa veprime të tij të zhvillohen me dyer të mbyllura:

a) kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit, në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga organi kompetent;

b) kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës;

c) kur është e nevojshme të mbrohet siguria e dëshmitarëve ose e të pandehurve;

ç) kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve si dëshmitarë.

d) kur viktima e përcaktuar në nenin 58/b, të këtij Kodi, kërkon të zhvillohet me dyer të mbyllura.

2. Shqyrtimi gjyqësor zhvillohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur:

a) gjykohen të miturit;

b) gjykohen të pandehur të rritur, të cilët akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë, pavarësisht moshës së viktimës gjatë gjykimit.

3. Vendimi i gjykatës për zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura revokohet kur pushojnë shkaqet që e sollën atë.

4. Kryetari i trupit gjykues informon personat që marrin pjesë në një gjykim me dyer të mbyllura për detyrimin që kanë për të mbajtur konfidencial informacionin e mësuar në seance. »

K.Pr.Penale në pajtim me dispozitën kushtetuese lidhur me publicitetin e seancave gjyqësore, ka ndërtuar standardin se në parim, gjykimi është publik, kurse përjashtimet nga ky parim janë përcaktuar në mënyrë eksplicite, pasi gjykimi mund të zhvillohet me dyer të mbyllura ekskluzivisht vetëm në

rrethanat e përcaktuara në nenin 340, dhe jo për arsye të tjera jashtë kësaj dispozite.

K.Pr.Penale përjashtimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin e parasheh si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që passjell pavlefshmëri të procesit. Nga vetë përcaktimi që i jep Kodi, kuptohet se kjo shkelje është një shkelje e një niveli të lartë, për të cilën Gjykata duhet të ketë vëmendje dhe kujdes të shtuar gjatë gjithë procedurës, dhe jo t'a trajtojë si një çështje dytësore, pasi shkelja e kësaj dispozite mund të ndikojë edhe në anulimin e tërësishëm të një procesi gjyqësor.

Edhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përcakton shprehimisht se gjykimi duhet të jetë publik. Në nenin 6 të KEDNJ-së përcaktohet se “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj...”. KEDNJ-së përcakton specifikisht rastet kur seanca gjyqësore mund të mbahet si e mbyllur.

Në këtë kuptim, neni 6 i KEDNJ-së përcakton se “*prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë*”.

Krahas KEDNJ-së, edhe Karta Europiane për të Drejtat Themelore e sanksionon shprehimisht gjykimin publik. Sipas kësaj karte, “Çdokush ka të drejtë në një seance të drejtë dhe publike brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Në anën tjetër, Lirinë e shprehjes e garanton edhe neni 10 i KEDNJ-së, sipas të cilit “*kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë*”. Edhe KEDNJ-ja përcakton se kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në rrethana specifike të cilat në bazë të listimit taksativ janë të përmendura në paragrafin 2 të nenit 10 të Konventës.

Ky paragraf përcakton se “Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”.

### **Neni 17 i Kushtetutës**

“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane .”

Në jurisprudencën e saj GjEDNJ-ja ka një mori rastesh në të cilat edhe ka vendosur standarde lidhur me publicitetin e seancave gjyqësore, standarde të cilat në bazë të parashikimeve Kushtetuese, duhet të zbatohen nga të gjitha Gjykatat në Shqipëri.

Në rastin Malhous kundër Republikës së Çekisë, GjEDNJ-ja ka theksuar rëndësinë që seancat gjyqësore të jenë publike:

“Gjykata rithekson se mbajtja publike e seancave gjyqësore përbën një parim themelor të sanksionuar në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ. Ky karakter publik i mbron palët ndërgjygjëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur pa shqyrtim publik. Gjithashtu, është një nga mënyrat me anë të së cilës mund të mbahet besimi në gjykata. Duke e bërë administrimin e drejtësisë në mënyrë transparente, publiciteti kontribon në arritjen e qëllimit të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ, që nënkupton një gjykim të drejtë, garancion, i cili është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, brenda kuptimit të KEDNJ.”

Ndërsa, përse i përket procedurës para gjykatës së shkallës së dytë apo të tretë, GjEDNj-ja në rastin *Helmers kundër Suedisë* ka përcaktuar se nga veçoritë e veçanta të procedurës në fjalë dhe me kusht që shqyrtimi publik të jetë mbajtur në gjykatën e shkallës së parë, mungesa e shqyrtimit publik mund të jetë e justifikuar.

Në lidhje me përjashtimin ose mos përjashtimin e mediave dhe publikut nga një seancë gjyqësore, GjEDNj-ja ka përcaktuar se këtë rrethanë, Gjykata do t'a përcaktojë duke analizuar rrethanat e secilit rast veç e veç. Sipas GjEDNj-së, *kufizimi i gjykimit për publikun dhe mediat, në rastet e përcaktuara, duhet të kufizohet në masën që është rreptësisht e nevojshme për të arritur qëllimin e kërkuar.*

Kjo Gjykatë, në rastin *Nikolova dhe Vandova kundër Bullgarisë* ka theksuar se:

*“Megjithatë, Gjykata edhe më parë ka konstatuar se prania e thjeshtë e një informacioni të kualifikuar në shkresat e lëndës nuk nënkupton automatikisht nevojën e mbylljes së gjykimit për publikun, pa vlerësuar domosdoshmërinë për mbylljen e gjykimit, përmes peshimit të parimit që seancat duhet të jenë publike dhe nevojën për të mbrojtur rendin publik dhe sigurinë kombëtare. Prandaj, para përjashtimit të publikut nga një pjesë e caktuar e procedurës, gjykatat duhet të shqyrtojnë nëse një përjashtim i tillë është i domosdoshëm në rrethana specifike për të mbrojtur një interes publik, dhe po ashtu duhet të kufizohet në masën që është rreptësisht e nevojshme për të arritur qëllimin e kërkuar”.*

Në bazë të standardeve të sipërcituara të vendosura nga GjEDNj-ja, gjykata duhet të ketë kujdes me rastin e përcaktimit nëse duhet përjashtuar publiku apo jo nga pjesëmarrja në një seancë gjyqësore. Përkundër faktit se rrethanat në të cilat duhet të merret ky vendim janë të përcaktuara taksativisht, standardet e GjEDNj-së përcaktojnë se këto rrethana duhet të vlerësohen drejt, në varësi të rrethanave të secilit rast. Për rrjedhojë, jo çdo pretendim apo prezencë e një elementi të tillë në një rast, e arsyeton edhe përjashtimin e publikut nga një seancë gjyqësore. Po ashtu, edhe përjashtimi i publikut duhet të jetë i kufizuar deri në masën që është e domosdoshme për të arritur



qëllimin e synuar. Si konkluzion, konstatohet se standardet e GjEDNj-së për këtë çështje janë shumë të larta, duke i dhënë rëndësi të madhe respektimit të këtij parimi.

Referuar rastit Qyno, përkundër kërkesave ligjore dhe standardeve të GjEDNj-së, Gjykata nuk ka dhënë arsyetim lidhur me peshimin në mes parimit të publicitetit të seancave, përkatësisht interesit të publikut për t'u informuar lidhur me këtë rast, dhe rasteve që ligji parashikon për zhvillimin e një séance gjyqësore me dyer të mbyllura. Po ashtu, Gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me faktin se pse kjo masë është më e duhura apo nëse është e domosdoshme për t'u arritur qëllimi i kërkuar.

Avokati i Popullit vlerëson se vendime të tilla më së paku paraqesin mungesë transparence dhe llogaridhënieje të sistemit gjyqësor përballë publikut.

Për më tepër, gjykime të tilla vetëm sa e minojnë transparencën për publikun dhe paraqesin precedent të panevojshëm në sistemin gjyqësor, në kushtet kur sistemi gjyqësor, në bazë të raporteve vendore dhe ndërkombëtare, vazhdon të ketë probleme të theksuara përsa i përket transparencës dhe llogaridhënies përballë publikut, mediave dhe shoqërisë civile.

Transparenca dhe publiciteti gjatë procedurave gjyqësore janë elemente substanciale, të cilat ndikojnë në ngritjen e besimit të qytetarëve në drejtësi dhe i japin kuptim administrimit të drejtësisë. Për më tepër, transparenca në administrimin e drejtësisë kontribuon në sigurimin e një gjykimi të drejtë, duke krijuar mundësi që mediat të ushtrjnë rolin që kanë si kontrollues publik.

Duke qenë se proceset gjyqësore janë të hapura për publikun, akreditimi i gazetarëve zakonisht nuk është i nevojshëm, përveçse kur dëshirojnë të bëjnë regjistrim audio dhe video ose fotografim të ambienteve të brendshme të gjykatës. Regjistrimi i seancës në sallën e gjyqit mund të miratohet nga kryetari i gjykatës me pëlqimin e kryetarit të trupit gjyqësor dhe pëlqimin me shkrim të palëve ndërgjyqëse dhe të pjesëmarrësve në regjistrim, pas shqyrtimit të interesit publik, interesit të procedurës dhe jetën private dhe sigurinë e pjesëmarrësve në proces.

Nevoja për të krijuar një komunikim proaktiv dhe të qartë me qytetarët gradualisht çon në ngritjen e nivelit të besimit të qytetarëve ndaj gjyqësorit. Në përputhje me këtë, shumë gjykata dhe zyra të prokurorive kanë miratuar strategjitë e komunikimit që synojnë rritjen e nivelit të respektit dhe besimit të qytetarëve ndaj sistemit gjyqësor dhe vendimeve të tij dhe ofrojnë informacion me anë të të cilit ndihmojnë qytetarët të kuptojnë më mirë procedurën gjyqësore.

*“Në këtë mënyrë qytetarët mund të kuptojnë më mirë mënyrën e funksionit të gjykatës, arsyen përse ndërmerren disa veprime të caktuara, cilat janë rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Gjithashtu, qytetarët do të njohin më mirë kufizimet që ndikojnë në punën e gjykatës. Nëse qytetarët janë të mirëinformuar, reduktohen gjasat për një mbulim mediatik të pasaktë dhe të bujshëm që ndikojnë në to”.*

Shumë gjykata dhe zyra të prokurorisë kanë emëruar persona përgjegjës për marrëdhëniet me publikun, të cilët janë përgjegjës për komunikimin me median. Megjithatë, faqet e tyre të internetit, ende, ndryshojnë në cilësi dhe përmbajtje dhe ka një përpjekje të vazhdueshme për të unifikuar pamjen dhe funksionalitetin e tyre. Broshurat informative të publikuara në faqet e internetit mund të jenë të dobishme në kryerjen e kërkimeve.

Avokati i Popullit vlerëson se publiciteti i seancave gjyqësore duhet të kuptohet në atë formë që në asnjë rrethanë nuk e dëmton administrimin e drejtësisë. Në të kundërtën, siç e përcakton edhe praktika e GjEDNj-së, ajo i mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur dhe është një nga mënyrat me anë të së cilës mbahet besimi në gjykata.

Sipas vlerësimit tonë, prania në seancë gjyqësore e përfaqësuesit të institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është i vetmi institucion kushtetues i mbrojtjes së të drejtave e lirive të njeriut në vend dhe që përfaqëson një interes të gjerë publik, **nuk çënon asnjë dispozitë të Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.Penale).**

Përkundrazi, kjo prani do të përbënte një garanci më shumë për ankuesin në kuadër të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Sjellim në

vëmendje se kjo Gjykatë nuk ka mbajtur në konsideratë misionin kushtetues që ka institucioni i Avokatit të Popullit të parashikuar në nenin 60 të Kushtetutës ku shprehimisht përcaktohet se:

*“1. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.*

*2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij.”*

Ka shumë rëndësi që të kuptohet qartë roli dhe pozicioni i Avokatit të Popullit në garantimin e të drejtave të shtetasve gjatë procedimit penal, pikërisht sepse ata janë më vulnerabël sa i takon respektimit të këtyre të drejtave. Nëse ky rol i Avokatit të Popullit, nuk arrin të kuptohet, apo më keq akoma, përpiqet të minimizohet nga organet e pushtetit gjyqësor, atëherë kjo reflekton se këtu problemi është në thelb, më i zgjeruar se sa në aparençë, është i dukshëm.

Për më tepër, në rastin konkret ndërthuret garantimi i më shumë se një të drejte kushtetuese, si ajo e procesit të rregullt ligjor, të drejtës së lirisë së shprehjes dhe paprekshmërisë së privatësisë, ndërkohë që bashkëpunimi ndërinstytucional duhet të jetë në një tjetër shkallë duke qenë se të drejtat e njeriut janë veçanërisht të këshillueshme për kohët e vështira, jo kur zbatohen rregullisht.

Avokati i Popullit e ka përdorur në proporcionalitet të dukshëm të drejtën për të marrë pjesë në procese gjyqësore dhe ka luajtur rolin e tij në këto çështje, ndaj ky qëndrim i GJKKO të Apelit për të ndaluar çfarëdo lloj pranie në këtë seancë, përbën një cenim thelbësor të të drejtave procedurale të shtetasit Elton Qyno.

Për më tepër, ndërsa prania e Avokatit të Popullit ishte lejuar në GJKKO të Shkallës së Parë, ndalimi në GJKKO të Apelit nuk mund të justifikohet me asnjë shkak të vlefshëm ligjor, për sa kohë që çdo informacion është marrë në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe gjykimi në Apel i nënshtrohet thjesht shkaqeve të ankimit dhe nuk ka në themel të tij shqyrtimin apo marrjen e provave të reja për të cilat përfaqësuesi i Avokatit të Popullit nuk duhej të ishte në dijeni.

Avokati i Popullit gjen rastin të theksojë se të drejtat procedurale të individit nuk parashikohen vetëm në Kodin e Procedurës Penale dhe se sistemi i garancive të qytetarëve/gazetarëve ndaj autoritetit shtetëror apo publik, është më i gjerë, duke u parashikuar në Konventa Ndërkombëtare, Kushtetutën tonë, Rezoluta të institucioneve Evropiane e Ndërkombëtare, në jurisprudencën e GJEDNJ-së, etj.

Avokati i Popullit vlerëson faktin se Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr. 716, datë 06.12.2023 ka miratuar “Udhëzuesin standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”.

Në këtë udhëzues përcaktohen rregullat dhe procedurat e informimit dhe komunikimit me publikun dhe median, me ose pa interesimin e tyre të drejtpërdrejtë, me qëllim përcjelljen e informacionit mbi veprimtarinë e gjykatës në mënyrë të drejtë, uniforme, të barabartë, të shpejtë dhe efikase.

**Ne çmojmë që në këtë udhëzues duhet të shtohet një dispozitë me qëllim që të parashikohet shprehimisht pjesëmarrja e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit edhe në seancat gjyqësore të cilat zhvillohen me dyer të mbyllura.**

Ky parashikim do të mënjanonte çdo dyshim mbi mandatin e Avokatit të Popullit që parashikohet në Kushtetutë, apo çdo tentativë në të ardhem, për të kufizuar kompetencat kushtetuese të tij, duke ndikuar më shumë në rritjen e transparencës të veprimtarisë gjyqësore dhe besimit të publikut tek këto struktura, nëpërmjet standardizimit të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median.

Ndërkohë, gjykatat nuk duhet të shmangin parimin themelor të gjykimit dhe zhvillimit të seancave gjyqësore të hapura për publikun dhe se zhvillimi i seancave të mbyllura duhet të jetë rast përjashtimor dhe i argumentuar lidhur me arsyet ligjore që e diktojnë këtë qëndrim.

Po ashtu, nga analiza e veprimeve tërësore të kryera në këtë rast mund të nxjerrim konkluzione për nevojën e ndryshime eventuale në procedurat e parashikuara, për të përmirësuar nëse është rasti të drejtat procedurale të palëve.

Gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se publiciteti i seancave gjyqësore, sipas KEDNj-së, është një nga elementet që formëson të drejtën për një proces të rregullt. Gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve specifike, vendimet e GjEDNj-së janë të obligueshme për t'u zbatuar në secilin rast. Për këtë arsye, është e domosdoshme që ata duhet t'i referohen praktikës së kësaj gjykate.

Vendimet për mbylljen e seancave duhet të jenë të arsyetuara konform kërkesave ligjore dhe standardeve të përcaktuara nga GjEDNj-ja dhe për këtë fushë ata duhet të trajnohen vazhdimisht. Gjyqtarët në asnjë rast nuk duhet të përjashtojnë publikun, mediat dhe shoqërinë civile nga seancat, pa marrë një vendim të shkruar dhe të arsyetuar mirë. Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë duhet të përcaktojnë praktika të drejta gjyqësore lidhur me hapjen dhe mbylljen e seancave për publikun, mediat dhe shoqërinë civile dhe prokurorët duhet të kundërshtojnë kërkesat e pabazuara për mbylljen e seancave gjyqësore.

Avokati i Popullit vlerëson se është e nevojshme të rritet vetëdija për ndikimin dhe rëndësinë e komunikimit, veçanërisht në rastet e nivelit të lartë dhe dialogu ndërmjet mediave dhe sistemit ligjor duhet të jetë i vazhdueshëm, veçanërisht, në kohën kur **nuk** shfaqen “kriza”, sepse atëherë është më e lehtë të zgjidhet “kriza” kur gjendemi përpara saj.

Sistemi gjyqësor duhet të dakordësohet me një strategji të komunikimit të procedimeve penale, d.m.th. kur, deri në çfarë mase, nga kush dhe për kë duhet të sigurohet informacioni, dhe është e domosdoshme që të gjithë subjektet t'i përmbahen kësaj strategjie dhe të përhapin mesazhin për sfondin dhe natyrën e saj, në kushtet kur sistemi gjyqësor në Shqipëri, duhet të garantojë parimin e shtetit ligjor, ndjekjen e drejtë penale dhe prezumimin e pafajësisë.

Për sa parashtruam më sipër, në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend* dhe me qëllim parandalimin e shkeljeve të tilla në të ardhmen,

## **REKOMANDOJMË :**

1. Vlerësimin dhe zbatimin nga SPAK dhe GJKKO e të dy shkallëve (e shkallës së parë dhe ajo e apelit) gjatë veprimtarisë hetimore e gjyqësore të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjithësi dhe të lirisë së medias në veçanti të parashikuara në Kushtetutë dhe KEDNJ sipas interpretimit të bërë nga GJEDNJ, për punonjësit e medias gjatë ushtrimit të profesionit të tyre në një shoqëri demokratike.
2. Analizimin nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor të gjetjeve dhe konstatimeve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë shqyrtimit të ankesës së gazetarit Elton Qyno dhe vlerësimin e masave që duhet të ndërmerren për të garantuar të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në çdo fazë të hetimit dhe/ose gjykimit.
3. Marrjen e masave nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për të garantuar monitorimin filmik dhe me audio të marrjes në pyetje të palëve në procesin penal si dhe garantimin e komunikimit të Kartes së të Drejtave në një gjuhë të përshtatshme për çdo person që ndërvepron me prokuroritë si palë në procesin penal.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për ndryshimin e përmirësimin e “Udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, miratuar me Vendimin Nr. 716, datë 06.12.2023. Në këtë udhëzues rekomandohet të shtohet një dispozitë e posaçme me qëllim që të garantohet pjesëmarrja e Avokatit të Popullit ose e përfaqësuesve të autorizuar prej tij dhe të pajisur me CSP edhe në seancat gjyqësore të cilat zhvillohen me dyer të mbyllura.
5. Vlerësimin dhe zbatimin e gjetjeve dhe rekomandimeve përgjithësuese të këtij raporti edhe nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.
6. Vlerësimin nga Ministria e Drejtësisë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të nevojës për ndryshimet ligjore për të rritur garancitë procedurale gjatë procesit penal për të tëra palët në këtë proces, konkretisht:

- Garantimin e të drejtës për t'iu asistuar me avokat për të tëra palët dhe subjektet e tjerë, pjesë e procesit penal si personi që ka dijeni për rrethanat e çështjes, dëshmitari e kallëzuesi jo i dëmtuar.
- Garantimin e të drejtës së çdo personi për t'iu komunikuar karta e të drejtave sipas pozicionit të tij procedural.
- Garantimin e të drejtës së jetës private në përputhje me nenin 8 të KEDNJ, sipas interpretimit të bërë nga GJEDNJ në lidhje me të drejtën e privatësisë dhe kritereve të kufizimit proporcional të kësaj të drejte në dritë të zhvillimeve teknologjike në mjetet e komunikimit.


Garatimin e ushtrimit efektiv të rolit dhe mandatit të Institucionit të Avokatit të Popullit si pjesë thelbësore të sistemit të kontroleve dhe ekuilibrave (check and balances) të shtetit të së drejtës në lidhje me garantimin thelbësor të të drejtave të njeriut në vend. Ky rekomandim të vlerësohet në nivel strukturor nga Komisioni i Ligjeve dhe Keshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Propozimet përkatëse për ndryshimet në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe Kodit të Procedurës Penale të bëhen menjëherë duke e përafuar atë me legjislacionin e BE, standardet më të larta të parashikuara në aktet ndërkombëtare dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

  
**Erinda BALLANCA**

**7 maj 2024**